



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. regjistri (JR) 80/2021
Datë 16.12.2021

Nr. 17 i vendimit
Datë 03.03.2025

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Ina Rama	Kryesuese
Sokol Çomo	Relator
Natasha Mulaj	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Albana Shtylla	Anëtare

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 20.02.2025, ora 10:00, si dhe më datë 03.03.2025, ora 14:10, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me Sekretar Gjyqësor Kevin Kovaçica, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 80/2021 (JR), datë 16.12.2021, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Erion Çelaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 448, datë 21.09.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Erion Çelaj.

BAZA LIGJORE: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni F i Aneksit, neni 179/5, pika 5; ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenet 61, 63 dhe 66; Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 6; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, neni 46.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr.84/2016”), shqyrtoi pretendimet dhe kërkimet e subjektit të rivlerësimit Erion Çelaj të paraqitura në ankim, i cili përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 448, datë 21.09.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin e tij në detyrë, dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Erion Çelaj (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për shkak të ushtrimit të funksionit të prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex officio*, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016.
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente, brenda afatit ligjor, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës dhe formularin për vetëvlerësimin profesional.
3. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) ka administruar raportet e hartuara nga institucionet ndihmëse, nga të cilat ka rezultuar si vijon.

3.1. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, i ka përcjellë Komisionit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, në të cilin ka konstatuar se:

- (i) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- (ii) ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar burimin e krijimit të pasurive;
- (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë;
- (v) nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

3.2. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe, në zbatim të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, ka përcjellë raportin e grupit të punës, i cili ka ndryshuar konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit, nga përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës në papërshtatshmëri për vazhdimin e detyrës¹.

¹ Raporti mbi kontrollin e figurës nr. {***} prot., datë 8.3.2021, deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. {***}, datë 18.3.2021, të KDZH-së.

- 3.3. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke shqyrtuar dokumentet ligjore të hartuara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, dhe ka miratuar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar².
4. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe grupi i punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Erion Çelaj, bazuar në tri kriteret e vlerësimit (vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale).

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

5. Komisioni, me vendimin nr. 448, datë 21.09.2021, vendosi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Erion Çelaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.
6. Ky vendim është marrë bazuar në nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, në vijim të konkluzioneve të mëposhtme.
- 6.1. Në lidhje me vlerësimin e kriterit të pasurisë: *bazuar në konkluzionet për çdo pasuri, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe gjendet në kushtet e parashikuara në pikat 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*
- 6.2. Në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, në vendimin objekt kontrolli nuk është mbajtur qëndrim nëse subjekti i rivlerësimit ka arritur ose jo nivel të besueshëm.
- 6.3. Në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale: *në vlerësimin tërësor të kriterit të aftësive profesionale, problematikave të evidentuara dhe të shqyrtuara në këtë vendim vlerësohet se nuk përmbajnë shkelje serioze dhe nuk kanë shkaktuar pasoja të rënda procedurale për palët në mënyrë që subjekti i rivlerësimit të kualifikohet “i papërshtatshëm” nga ana profesionale.*
- 6.4. Në lidhje me vlerësimin tërësor të problematikave të analizuara në seksionin e vendimit “Konstatimet e tjera”: *bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, duke u gjendur në kushtet e pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*
- 6.5. Konkluzioni përfundimtar: *në përfundim, trupi gjykues, bazuar në konkluzionet e mësipërme, vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, si dhe ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, bazuar në pikat 1, 3, 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe pikat 3 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*

² Raporti nr. {***} prot., datë 08.07.2020.

III. Ankimi i subjektit të rivlerësimit

7. Kundër vendimit nr. 448, datë 21.09.2021, të Komisionit, subjekti i rivlerësimit Erion Çelaj ka ushtruar të drejtën e ankimit duke kërkuar: (i) Gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike. (ii) Ndryshimin e vendimit nr. 448, datë 21.09.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Erion Çelaj, prokuror pranë Prokurorisë së Apelit Vlorë.

IV. Shqyrtimi i ankimit në Kolegjin e Posaçëm të Apelit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

8. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka në objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka kryer rivlerësimin e subjektit Erion Çelaj, duke vendosur shkarkimin e tij nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

9. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

10. Në përputhje me nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull kryhet në dhomë këshillimi. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit nr. 448, datë 21.09.2021, të Komisionit, bazuar në shkaqet e ngritura në ankimin e subjektit të rivlerësimit, u mor fillimisht në shqyrtim nga Kolegji në dhomë këshillimi.
11. Në vijim, trupi gjykues, pasi shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për kalimin e çështjes për gjykim në seancë gjyqësore publike, në praninë e tij, si dhe kontrolloi zhvillimin e procesit të rivlerësimit në Komision, nëpërmjet dokumentacionit të administruar në fashikullin e Komisionit, nuk konstatoi shkelje procedurale të tilla që të kërkonin korrigjimin e tyre sipas parashikimeve të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”). Për rrjedhojë, trupi gjykues vendosi të mos pranojë kërkesën për kalimin e

çështjes në seancë gjyqësore publike dhe të vijojë shqyrtimin e saj në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012.

B. Shkaqet e ankimit që lidhen me aspekte procedurale të procesit të rivlerësimit në Komision dhe vlerësimi i trupit gjykues

12. Subjekti i rivlerësimit e kundërshton vendimin e Komisionit, duke pretenduar se ai është marrë në shkelje të parimeve të procesit të rregullt ligjor, të parashikuara nga neni 6 i KEDNj-së dhe neni 42 i Kushtetutës, si dhe në kushtet e interpretimit të gabuar të provave të administruara gjatë hetimit administrativ dhe të zbatimit të gabuar të parashikimeve të Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
13. Kundërshtimet për procedurën e ndjekur nga Komisioni subjekti i rivlerësimit i ka bazuar në pretendimet si vijojnë.
 - 13.1. Komisioni ka vendosur një barrë prove të paarsyeshme, joproporcionale dhe joobjektive, në kundërshtim me parashikimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, neneve 52 dhe 61 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit 87 të Kodit të Procedurave Administrative.
 - 13.2. Komisioni nuk ka përmbushur detyrimin ligjor për kalimin e barrës së provës për çdo gjetje që, sipas vlerësimit të tij, përbën mospërmbushje të detyrimeve ligjore nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe që passjell marrjen e një mase disiplinore. Sipas subjektit, mospërmbushja e këtij detyrimi përbën shkelje të procesit të rregullt ligjor në kuptim të neneve 42 dhe 179/b, pika 2 e Kushtetutës, si dhe nenit 6 të KEDNj-së.
 - 13.3. Kalimi i barrës së provës duhet të përbëjë një moment procedural të qartë dhe të komunikuar drejtpërdrejt subjektit të rivlerësimit, me qëllim garantimin e së drejtës së tij për të paraqitur prova dhe argumente, për t’u dëgjuar drejtësisht dhe për t’u mbrojtur në mënyrë efektive në kuadër të procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 6/1 të KEDNj-së.
 - 13.4. Komisioni, në zbatim të nenit 87 të Kodit të Procedurave Administrative, përpara se t’i jepte mundësinë subjektit për t’u dëgjuar, duhet t’i bënte të njohura jo vetëm rezultatet e hetimit administrativ, por edhe rezultatet e pritshme të procedurës administrative.
 - 13.5. Barra e provës, sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës, vendoset vetëm në rastet kur pasuria e subjektit rezulton më e madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme ose kur pasaktësitë në deklaram kanë për qëllim fshehjen e pasurive.
 - 13.6. Procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, megjithëse me natyrë disiplinore, duhet të zhvillohet në përputhje me parimet e parashikuara nga ligji nr. 96/2016, ndër të cilat edhe parimi i prezumimit të pafajësisë.
 - 13.7. Ndonëse procesi i rivlerësimit është një proces i jashtëzakonshëm, ai nuk mund të kufizojë të drejtën për një proces të rregullt ligjor, si një e drejtë themelore që nuk u nënshtrohet kufizimeve edhe në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme.

13.8. Subjekti pretendon se, në asnjë moment gjatë hetimit administrativ, nuk i është njoftuar shkelja e pretenduar dhe se cenimi i besimit të publikut të drejtësia është përmendur ndaj tij vetëm në vendimin përfundimtar të Komisionit.

13.9. Konkluzionet e arritura nga Komisioni janë të pabazuara dhe në kundërshtim flagrant me rregullat e procesit të rregullt ligjor, pasi barra e provës nuk i është kaluar për këto shkaqe, ndërsa konkluzionet e vendosura në themel të vendimit mbështeten në dyshime dhe jo në fakte të provuara, në kundërshtim me parimet që rregullojnë procesin disiplinor.

14. Lidhur me këto pretendime, trupi gjykues, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të Komisionit në raport me arsyetimin e vendimit objekt kontrolli dhe pretendimet e ngritura në ankim nga subjekti i rivlerësimit, konstaton dhe vlerëson si vijon.
15. Subjekti i rivlerësimit nuk ka specifikuar konkretisht se në cilin aspekt Komisioni ka tejkaluar parashikimet ligjore për barrën e provës. Nga kontrolli i procedurës së ndjekur nga Komisioni në rastin konkret, trupi gjykues nuk konstaton shkelje të dispozitave që rregullojnë barrën e provës gjatë hetimit administrativ.
16. Subjekti i rivlerësimit është njohur me tri pyetësorët e dërguar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ dhe ka paraqitur përgjigje në lidhje me to. Gjithashtu, ai është njohur me barrën e provës të kaluar nga Komisioni në përfundim të hetimit administrativ, ndaj së cilës ka paraqitur prapësime dhe prova. Në vijim, subjekti është dëgjuar edhe në seancë dëgjimore lidhur me pretendimet e tij mbi procesin e rivlerësimit.
17. Nga analiza e raportit mbi rezultatet e hetimit administrativ të Komisionit, trupi gjykues konstaton se në të janë pasqyruar provat e administruara, shpjegimet e subjektit, si dhe konstatimet për të cilat, në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës.
18. Dispozitat e kuadrit ligjor të rivlerësimit kalimtar nuk parashikojnë detyrimin që Komisioni, në këtë fazë procedurale, të shprehet paraprakisht për ekzistencën e shkeljeve ligjore apo për aplikimin e një mase disiplinore. Për më tepër, subjektet e rivlerësimit, për shkak të formimit dhe përvojës së tyre profesionale, kanë aftësinë të vlerësojnë peshën e konstatimeve të Komisionit në raport me parashikimet e ligjit nr. 84/2016 për aplikimin e masave disiplinore, edhe në referim të nenit 87 të Kodit të Procedurave Administrative.
19. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni nuk i ka kaluar barrën e provës për çdo gjetje që, sipas vlerësimit të tij, përbënte mospërmbushje të detyrimeve ligjore me pasojë marrjen e një mase disiplinore, trupi gjykues vëren se subjekti nuk ka referuar në mënyrë konkrete gjetjet për të cilat pretendon se nuk është njohur me barrën e provës. Pretendimet e subjektit lidhur me konstatimin e situatës faktike dhe zbatimin e parashikimeve ligjore nga Komisioni, do të analizohen në vijim, në kuadër të shqyrtimit të secilit prej kriterëve të rivlerësimit.
20. Sa i takon pretendimit se kalimi i barrës së provës duhet të përbëjë një moment procedural të qartë dhe të komunikuar drejtpërdrejt subjektit të rivlerësimit, me qëllim garantimin e së drejtës së tij për të paraqitur prova dhe argumente, për t'u dëgjuar drejtësisht dhe për t'u mbrojtur në mënyrë efektive në kuadër të procesit të rregullt ligjor, trupi gjykues vëren se, nga përmbajtja

e raportit mbi rezultatet e hetimit administrativ, rezulton se për secilin kriter vlerësimi, Komisioni ka evidentuar veprimet konkrete hetimore dhe aktet e administruara, në analizën e të cilave ka mbështetur konkluzionet përkatëse mbi situatën faktike dhe gjetjet për të cilat i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës.

21. Rezultoni se subjektit i është vënë në dispozicion dosja hetimore e krijuar nga Komisioni, si dhe i është lënë një afat i arsyeshëm për paraqitjen e shpjegimeve dhe provave të nevojshme. Paraqitja e provave, shpjegimeve dhe prapësimeve nga subjekti, si gjatë fazës së hetimit administrativ, ashtu edhe në seancën dëgjimore, dëshmon se ai e ka kuptuar në mënyrë të qartë kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, dhe ka ushtruar të drejtën e mbrojtjes.
22. Në këtë mënyrë, Komisioni, në kuptim dhe zbatim të nenit 87³ të Kodit të Procedurave Administrative, ka përmbushur detyrimin e tij si organ administrativ, duke garantuar të drejtën e subjektit për t'u njohur me provat e administruara dhe me rezultatet e hetimit, si dhe për të paraqitur prova dhe argumente lidhur me gjetjet e rezultuara nga ky hetim administrativ.
23. Gjithashtu, nga procesverbali i seancës dëgjimore të datës 09.09.2021, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka dhënë vlerësimin e tij mbi rezultatet paraprake të hetimit, si dhe ka paraqitur argumentet dhe provat, duke ushtruar të drejtat e parashikuara nga ligji për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur.
24. Në rast se Komisioni do t'i njoftonte subjektit të rivlerësimit shkelje konkrete dhe bazën ligjore të kualifikimit të tyre pa i dhënë mundësinë të dëgjohej dhe të paraqiste prova lidhur me provimin e së kundërtës të barrës së provës, në vlerësimin e trupit gjykues do ishte një qëndrim paragjykues ndaj subjektit të rivlerësimit.
25. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se barra e provës, sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës, vendoset vetëm në rastet kur pasuria e subjektit rezulton më e madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme ose kur pasaktësitë në deklaram synojnë fshehjen e pasurive, trupi gjykues e gjen atë të pabazuar në parashikimet ligjore të procesit të rivlerësimit dhe në jurisprudencën e Kolegjit⁴. Në vlerësimin e trupit gjykues, neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe neni 30 i ligjit nr. 84/2016 i kërkojnë subjektit të rivlerësimit të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave.
26. Lidhur me pretendimin e subjektit se në procesin e rivlerësimit kalimtar duhet të zbatohen edhe parimet e procesit penal dhe ato të procedimit disiplinor, të parashikuara në nenin 100 të ligjit

³ Neni 87, "Njoftimi dhe e drejta për t'u dëgjuar para marrjes së vendimit përfundimtar", parashikon: "1. Përpara se të merret vendimi përfundimtar, organi publik, përveç rasteve të parashikuara nga neni 64 i këtij Kodi, njofton palën lidhur me të drejtën e saj për t'u dëgjuar. 2. Njoftimi, sipas pikës 1 të këtij neni, bëhet me shkrim, apo në një takim me palën, dhe përmban këto të dhëna: a) organin publik që zhvillon procedurën dhe nëpunësin publik përgjegjës; b) palët e përfshira; c) informacion për të drejtën e inspektimit të dosjeve dhe zyrës dhe vendin ku kjo mund të ushtrohet; ç) provat e administruara, rezultatet e hetimit, si dhe rezultatet e pritshme të procedurës administrative dhe motivimin përkatës; d) informacionin për të drejtën e palës për t'u dëgjuar dhe mënyrën dhe afatin e ushtrimit të kësaj së drejte; dh) datën e fillimit të procedurës dhe afatin kohor, brenda të cilit do të merret dhe njoftohet vendimi, në qoftë se një afat i tillë është i zbatueshëm".

⁴ Shih vendimet e Kolegjit nr. 19/2019 (JR); nr. 19/2022 (JR).

nr. 96/2016, si parimi i prezumimit të pafajësisë dhe ai i dyshimit në favor të magjistratit, në referim edhe të opinioneve të Komisionit të Venecias⁵, trupi gjykues vlerëson se procesi i rivlerësimit ka një natyrë të jashtëzakonshme, të ndryshme nga procesi penal dhe proceset e zakonshme disiplinore, kuadri ligjor i të cilit, pas kontrollit nga Gjykata Kushtetuese dhe GjEDNj-ja, është vlerësuar në përputhje me parashikimet e Kushtetutës dhe KEDNj-së.

27. Në përfundim të analizës së mësipërme trupi gjykues vlerëson se pretendimet e subjektit të rivlerësimit për shkelje të rënda procedurale dhe cenim të parimeve të procesit të rregullt ligjor gjatë zhvillimit të procesit të rivlerësimit në Komision rezultojnë të pabazuara në fakte dhe në ligj.

C. Shkaqet e ankimit që lidhen me kriteret e rivlerësimit dhe vlerësimi i trupi gjykues

C.1. Lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë

➤ *Në lidhje me pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 116 m², ndodhur në {***}, Tiranë:*

28. Në lidhje me këtë pasuri, Komisioni ka vlerësuar se: *Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm dhe jo në përputhje me ligjin dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë, duke u gjendur në kushtet e pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.*
29. Subjekti i rivlerësimi e ka kundërshtuar këtë vlerësim të Komisionit duke pretenduar se e ka deklaruar saktësisht dhe me vërtetësi këtë pasuri dhe nuk është përpjekur as ta fshehtë dhe as ta paraqesë në mënyrë të pasaktë atë. Mënyra e përfitimit të kësaj pasurie është deklaruar saktësisht në Deklaratën e Interesave Periodikë Privatë (në vijim “DIPP”) të vitit 2012 dhe deklaratën *vetting*, dhe se nuk gjendet në kushtet e pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
30. Ankuesi nuk ka pasur fluks dalës për përfitimin e kësaj pasurie dhe, në të tilla kushte, nuk mund të ketë deklarim të pamjaftueshëm sipas germës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.
31. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se konkluzionet e Komisionit lidhur me këtë pasuri, janë të pabazuara dhe se faktet e konstatuara dhe të analizuara prej tij nuk mund të ngrihen në nivelin e një shkaku për shkarkim nga detyra. Sipas subjektit, vendimi objekt ankimi nuk përmban arsyetim të mjaftueshëm lidhur me mosmarrjen në konsideratë të pretendimeve dhe shpjegimeve të paraqitura prej tij në funksion të përmbushjes së barrës së provës, çka, sipas tij, e bën vendimin të paarsyetuar dhe, për rrjedhojë, të cenueshëm.
32. Subjekti i rivlerësimit e ka bazuar shkakun e ankimit në pretendimet e mëposhtme.
- 32.1.** Apartamenti është përfituar nga vjehri i tij si kundërvlerë e punimeve elektrike të kryera në bazë të aktmarrëveshjes së lidhur ndërmjet shoqërisë “{***}” ShPK në cilësinë e porositësit dhe shoqërisë “{***}” ShPK dhe z. Sh. I. në cilësinë e sipërmarrësve.

⁵ *Subjekti referon në opinionin nr. 789, datë 15.12.2014, të Komisionit të Venecias (Amicur Curia për Gjykatën Kushtetuese të Moldavisë): “63. Nisur nga ngjashmëria midis procedimit disiplinor të gjyqtarëve dhe procedimit penal, parimi procedural penal i parashikueshmërisë së shkeljeve ligjore dhe të interpretimit të tyre të ngushtë (moslejimi i interpretimit me analogji), zbatohet mutadis mutandis edhe në procedimin disiplinor”.*

32.2. Sipas subjektit, ai nuk ka qenë në dijeni të punimeve që kryente vjehri i tij dhe nuk ka disponuar aktmarrëveshjen deri në momentin e dorëzimit të saj pranë ILDKPKI-së në vitin 2016. Marrëdhënia financiare, sipas tij, ishte zgjidhur që në vitin 2007 përmes kryerjes së punimeve dhe apartamenti përfaqësonte kundërvlerën e shërbimit të kryer prej vjehrit të tij.

32.3. Ankuesi ka rënë në dijeni të situatës financiare vetëm në vitin 2012 kur është lajmëruar nga z. Sh. P. për kryerjen e veprimeve noteriale dhe kalimit të pronësisë për këtë apartament.

32.4. Subjekti pretendon se shprehja në kontratën e vitit 2012, “likuidimi është bërë jashtë zyrës noteriale”, i referohet pikërisht likuidimit të vlerës së punimeve elektrike të kryera. Ai shton se, në momentin e nënshkrimit të kontratës, nuk i ka kushtuar rëndësi përmbajtjes së saj, pasi ishte informuar nga shoqëria mbi mënyrën e përfitimit të apartamentit dhe kishte prezumuar se detyrimet tatimore përkatëse ishin përmbushur nga shoqëria, për punimet e kryera rreth pesë vite më parë.

32.5. Kontrata e shitjes nuk i referohet aktmarrëveshjes për shkak të mospagimit të detyrimeve tatimore që shoqëria “{***}” ShPK duhej të paguante në formën e tatimit në burim për të ardhurat e realizuara nga shërbimi i kryer prej vjehrit të tij, në cilësinë e një individi të pargjistruar në organet tatimore. Ai pretendon se, në kohën përkatëse, transaksionet e tipit “klering” nuk njiheshin si mënyrë likuidimi për përfitimin e pasurive të paluajtshme dhe se, në momentin e kalimit të pronësisë, që konsiderohej edhe momenti i pagesës, shoqëria ndërtuese do të duhej të paguante tatimin në burim në masën 10%, ose rreth 4.700 euro.

32.6. Mosparaqitja e faturave nga shoqëria “{***}” ShPK mund të lidhet me parregullsi në faturimin e plotë të shërbimit ndaj shoqërisë “{***}” ShPK. Nga ana tjetër, faturat e kësaj të fundit nuk mund të gjenden për shkak të kalimit të afatit 5-vjeçar të ruajtjes së dokumentacionit financiar, të përcaktuar nga legjislacioni përkatës. Sipas dokumentacionit të administruar nga DRT Elbasan, për shoqërinë “{***}” ShPK, ekzistojnë fatura për vitin 2007, por jo për vitin 2008, që, sipas subjektit, përkon me periudhën kur duhej të ishte lëshuar fatura përfundimtare për punimet e kryera. Lidhur me mungesën e dokumenteve justifikuese, subjekti pretendon se ndodhet në kushtet e nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pasi nuk legjitimohet si palë për të kërkuar informacion të mbrojtur nga ligji nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

32.7. Të ardhurat e përfituara nga vjehri i tij janë të ligjshme, pasi burojnë nga një aktivitet i ligjshëm ekonomik, i njohur si i tillë nga legjislacioni tatimor, i cili parashikon mundësinë e kryerjes së shërbimeve edhe nga persona të pargjistruar, ndërsa detyrimi për mbajtjen dhe pagesën e tatimit në burim u takon personave të tretë që kryejnë pagesën.

32.8. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti i rivlerësimit i referohet jurisprudencës së Kolegjit⁶, sipas së cilës, në disa raste, të ardhurat janë konsideruar të ligjshme edhe kur detyrimi për pagesën e tatimeve nuk ka rënduar mbi subjektin e rivlerësimit, por mbi persona të tretë që, sipas legjislacionit tatimor, kishin detyrimin për të mbajtur tatimin në burim.

⁶ Subjekti i referohet vendimit nr. 14/2021 të Kolegjit, si dhe vendimeve nr. 212/2019 dhe nr. 309/2020 të Komisionit.

32.9. Subjekti pretendon se apartamenti dhe burimi i përfitimit të tij janë deklaruar rregullisht si në deklaratën periodike të interesave private të vitit 2012, ashtu edhe në deklaratën e rivlerësimit kalimtar, ndaj nuk mund të mbajë përgjegjësi për moskryerjen e detyrimeve tatimore nga ana e shoqërisë ndërtuese. Subjekti pretendon gjithashtu se Komisioni duhej ta analizonte këtë pasuri edhe në raport me konceptin e dyfishit të pasurisë së ligjshme.

32.10. Sipas informacionit të marrë nga shoqëria ndërtuese, numri i pasurisë i parashikuar në aktmarrëveshje është përcaktuar sipas listës së njërive të hartuara që në fazën e ndërtimit dhe të depozituara në kohë pranë Komunës {***}.

32.11. Subjekti i rivlerësimit pretendon se të drejtat pasurore mbi apartamentin, janë përfituar prej tij dhe bashkëshortes në zbatim të amanetit të lënë nga i ndjeri, vjehri i tij, sipas së drejtës zakonore shqiptare, ndërsa trashëgimtarët e tjerë të z. Sh. I. kanë hequr dorë nga të drejtat pasurore që rridhnin nga aktiviteti i tij gjatë viteve 2007–2008.

33. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të Komisionit në raport me arsyetimin e vendimit objekt kontrolli dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit në ankim, vlerëson si në vijim.

34. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Apartament banimi me sip. 116 m², nr. pasurie {***} (pallat) sh. {***}, k. {***}, ap. {***}, {***}, Tiranë, sipas kontratës së shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.5.2012. Kjo pasuri është përfituar sipas aktmarrëveshjes së porosisë të të ndjerit babait të bashkëshortes Sh. I. me shoqërinë “{***}” ShPK. Vlera 48.000 euro*”.

35. Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë nga subjekti i rivlerësimit në DIPP-2012: *Banesë me sip. 116 m², {***}, Tiranë, përfituar nga babai i bashkëshortes Sh. Vlera: 48.000 euro.*

36. Me kontratën e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.05.2012, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e palës blerëse, ka blerë nga pala shitëse, shoqëria “{***}” ShPK, apartamentin objekt kontrolli kundrejt çmimit prej 48.000 eurosh, shumë e cila rezulton të jetë paguar jashtë zyrës noteriale.

37. Me deklaratën *vetting*, krahas dokumentacionit ligjor të pasurisë⁷, subjekti ka bashkëlidhur aktmarrëveshjen “Për kryerje punimesh instalime elektrike”, datë 11.10.2007, dokument i thjeshtë, i nënshkruar ndërmjet shoqërisë “{***}” ShPK, në cilësinë e porositësit, dhe shoqërisë “{***}” ShPK, me administrator z. Sh. P., si dhe shtetasit Sh. I., vjehri i subjektit, në cilësinë e sipërmarrësve. Sipas kësaj aktmarrëveshjeje, pala sipërmarrëse merrte përsipër të kryente, për llogari të shoqërisë “{***}” ShPK, punimet për instalimet dhe pajisjet elektrike

⁷ Shkresë kthim përgjigjeje nr. {***} prot., datë 8.11.2016, lëshuar nga ZVRPP-ja Tiranë, kartela e pasurisë së paluajtshme nr. {***}, lloji “apartament”, me sip. 116 m², regjistruar në datën 31.5.2012, në emër të shtetasit Erion Çelaj, kartela e pasurisë së paluajtshme nr. {***}, lloji “apartament” me sip. 116 m², regjistruar në datën 10.11.2010, në emër të shoqërisë “{***}” ShPK, kërkesë për aplikim pranë ZVRPP-së Tiranë, për regjistrim të pasurisë nr. {***}, në emër të shtetasit Erion Çelaj, shoqëruar me mandatpagesat bankare për pagesat e detyrimeve tatimore, kontratë shitje pasurie të paluajtshme nr. {***}, datë 10.5.2012, nënshkruar ndërmjet palës shitëse shoqëria “{***}” ShPK dhe palës blerëse Erion Çelaj, bashkëlidhur ekstrakti historik i shoqërisë “{***}” ShPK, certifikatë për vërtetim pronësie nr. {***}, datë 18.11.2010, të pasurisë nr. {***}, lloji “apartament”, me sip. 116 m², në emër të shoqërisë “{***}” ShPK.

të kompleksit të banimit që po ndërtohej nga kjo e fundit, kundrejt vlerës totale prej 94.000 eurosh. Likuidimi i kësaj vlere do të kryhej nëpërmjet kalimit në pronësi të shumës përkatëse ose të dy apartamenteve me sipërfaqe 116 m² secili. Palët kanë rënë dakord që secili prej apartamenteve të vlerësohej në shumën prej 47.000 eurosh. Në përfundim të punimeve të përcaktuara në aktmarrëveshje, porositësi do të ndiqte procedurat ligjore për kalimin e pronësisë së apartamentit nr. {***}, të llojit “apartament”, me sipërfaqe 116 m², z. k. {***}, në favor të sipërmarrësve, përkatësisht shoqërisë “{***}” ShPK dhe shtetasit Sh. I.

38. Subjekti ka bashkëlidhur gjithashtu, deklaratën noteriale nr. {***}, datë 15.3.2016, të shtetasit Sh. P., i cili deklaron se, rreth viteve 2006-2007, së bashku me shtetasin Sh. I. kanë marrë përsipër kryerjen e punimeve elektrike në pallatet e ndërtuara nga shoqëria “{***}” ShPK dhe se, për këtë arsye, u është vënë në dispozicion një sipërfaqe ndërtimore prej 116 m². Sipas deklaramit të tij, gjatë kësaj periudhe, shtetasi Sh. I. ka ndërruar jetë dhe, për shkak të marrëdhënieve të mira shoqërore me familjarët e tij, apartamenti është marrë nga dhëndri i të ndjerit, z. Erion Çelaj, i cili ka nënshkruar kontratën dhe dokumentacionin për kalimin e pronësisë së apartamentit në emrin e tij, sipas dëshirës së shprehur nga z. Sh. I.
39. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr. {***}, datë 15.3.2016, të shtetasit T. I., e cila rikonfirmon marrëveshjen e nënshkruar nga bashkëshorti i saj i ndjerë, z. Sh. I, me shoqërinë “{***}” ShPK, si dhe faktin se apartamenti i përfutur sipas aktmarrëveshjes, në përputhje me vullnetin e bashkëshortit të saj, ka kaluar në emër të dhëndrit të tyre Erion Çelaj, sipas kontratës nr. {***}, datë 10.5.2012. Znj. T. I. deklaron gjithashtu se aktualisht banon në këtë apartament dhe se faturat e energjisë elektrike dhe ujit janë paguar rregullisht prej saj.
40. Në shpjegimet e dhëna pranë ILDKPKI-së më datë 26.02.2016, subjekti ka deklaruar se: *Babai i bashkëshortes, shtetasi Sh. I., ka punuar në fushën e instalimeve elektrike së bashku me shtetasin Sh. P., me të cilin kishin lidhje të vjetër miqësore. Sh. P. ka pasur aktivitet të regjistruar në QKR për kryerje punimesh, instalime elektrike etj., dhe kanë punuar së bashku. Për punimet që kanë kryer te firma “{***}” ShPK, kanë pasur marrëveshje për të përfutur jo vlerë parash, por sipërfaqe ndërtimore (hyrje), të cilat, me përfundimin e ndërtimit të objektit, do të bëheshin pronë e tyre. Ndërkohë, kur bëheshin procedurat e regjistrimit të ndërtimit fillimisht në emrin e shoqërisë dhe më pas kalimi në emrin e vjehrrit, ky i fundit ka ndërruar jetë, dhe jam vënë në dijeni nga familjarët dhe nga z. Sh. P., se dëshira e tij ishte që këtë apartament ta merrte për familjen e së bijës, pra unë duhej të shkoja pranë shoqërisë ndërtuese për të nënshkruar kontratën përfundimtare. Aktualisht në këtë apartament banon nëna e bashkëshortes, shtetasja T. I., e cila paguan energjinë dhe ujin. Mobilimi dhe kompletimi është bërë prej tyre.*
41. Sipas informacionit të përcjellë nga ASHK-ja Tiranë, apartamenti i ndodhur në {***}, me nr. {***}, me sipërfaqe 116 m², vol. {***}, f. {***}, z. k. {***}, është përfutur nga subjekti me anë të kontratës së shitblerjes nr. {***}, datë 10.5.2012, të lidhur ndërmjet shoqërisë “{***}” ShPK, në cilësinë e shitësit, dhe shtetasit Erion Çelaj, në cilësinë e blerësit, kundrejt çmimit

prej 48.000 eurosh, shumë e deklaruar si e likuiduar jashtë zyrës noteriale⁸. Sipas certifikatës së pronësisë nr. {***}, datë 18.11.2010, kjo pasuri ka qenë fillimisht e regjistruar në emër të shoqërisë “{***}” ShPK dhe më pas është regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit.

42. Nga dokumentacioni i administruar, rezulton gjithashtu se, me urdhrin nr. {***}, datë 14.08.2017, të lëshuar mbi bazën e kërkesës së subjektit, datë 21.06.2017, ASHK-ja ka kryer ndarjen e kësaj pasurie me sipërfaqe totale 116 m² në dy pasuri të veçanta të llojit “apartament”, përkatësisht me sipërfaqe 62 m² dhe 54 m². Në vijim, ASHK-ja konfirmon se subjekti i rivlerësimit Erion Çelaj figuron pronar i këtyre pasurive:
- (i) pasurisë nr. {***}, vol. {***}, f. {***}, z. k. {***}, të llojit “apartament”, me sipërfaqe 62 m², e regjistruar më datë 26.07.2017, me shënimin “ndarje pasurie”;
 - (ii) pasurisë nr. {***}, vol. {***}, f. {***}, z. k. {***}, të llojit “apartament”, me sipërfaqe 54 m², e regjistruar më datë 26.07.2017, po me shënimin “ndarje pasurie”.
43. Subjekti ka depozituar si provë deklaratën noteriale nr. {***}, datë 21.06.2021, të shtetasit R. Z., administrator i shoqërisë “{***}” ShPK, në të cilën ai deklaron se, në cilësinë e porositësit, në datën 11.10.2007 ka lidhur marrëveshje për kryerjen e punimeve elektrike me shoqërinë “{***}” ShPK dhe shtetasin Sh. I., ku është rënë dakord që pagesa për këto punime të kryhej në shumën prej 94.000 eurosh ose nëpërmjet kalimit në pronësi të dy apartamenteve me sipërfaqe 116 m² secili, të vlerësuar në shumën prej 47.000 eurosh secili.
44. Në deklaratë thuhet se punimet e kërkuara janë përmbushur rregullisht sipas aktmarrëveshjes dhe se, pas përfundimit të objektit në {***}, Tiranë, z. k. {***}, shoqëria ka realizuar regjistrimin e plotë të objektit pranë ZVRPP-së Tiranë. Më tej, deklarohet se, në përmbushje të detyrimeve kontraktore, shtetasit Sh. I. i takonte apartamenti me nr. pasurie {***}, z. k. {***}, vol. {***}, f. {***}, dhe se familjarët e tij kanë dhënë pëlqimin për kalimin e pronësisë së kësaj pasurie në emër të dhëndrit të tij, shtetasit Erion Çelaj.
45. Në lidhje me diferencën prej 1.000 eurosh ndërmjet vlerës së përcaktuar në aktmarrëveshje dhe çmimit të pasqyruar në kontratën e shitblerjes, z. R. Z. deklaron se kjo diferencë lidhet me kryerjen e punimeve shtesë në apartament, si: punime gipsi, pllakash dhe hidrosanitare, jashtë projektit fillestar. Ai deklaron gjithashtu se vlera e përcaktuar në kontratën e shitjes nuk është paguar nga blerësi, pasi detyrimi konsiderohet i përmbushur mbi bazën e aktmarrëveshjes së sipërpërmendur për punimet e kryera nga shtetasi Sh. I., në cilësinë e palës sipërmarrëse, ndaj shoqërisë “{***}” ShPK, në cilësinë e palës porositëse, duke e konsideruar të shlyer çdo marrëdhënie detyrimi ndaj shtetasit Sh. I. dhe familjarëve të tij.
46. Komisioni ka konstatuar se në aktmarrëveshjen e vitit 2007, është parashikuar kalimi në favor të sipërmarrësve, përkatësisht shoqërisë “{***}” ShPK dhe shtetasit Sh. I., i apartamentit me sipërfaqe 116 m², nr. {***}, z. k. {***}, pasuri e cila më pas ka kaluar në pronësi të subjektit të rivlerësimit. Komisioni ka evidentuar gjithashtu se në këtë aktmarrëveshje nuk është

⁸ DPPP-ja, me shkresën nr. {***}, datë 21.1.2021, informon se subjekti Erion Çelaj në datën 14.6.2012 ka kryer transaksion në vlerën 48.000 euro në favor të shoqërisë “{***}” ShPK, për blerjen e një apartamenti me kontratën nr. {***}.

specifikuar apartamenti tjetër që do të përfitohej nga shoqëria “{***}” ShPK, ndonëse në marrëveshje parashikohet kalimi në pronësi i dy apartamenteve.

47. Gjatë hetimit administrativ, Komisioni e ka pyetur subjektin lidhur me marrëdhënien tregtare ndërmjet shoqërisë “{***}” ShPK dhe shoqërisë “{***}” ShPK, si dhe mbi ekzistencën e dokumentacionit shoqëruar, të tilla si aktrakordime, fatura shitjeje etj., subjekti ka deklaruar se u është drejtuar me shkresë zyrtare të dyja shoqërive për t’i vënë në dispozicion dokumentacionin e kërkuar, të cilin do t’ia përcillte Komisionit sapo ta administronte.
48. Subjekti i rivlerësimit është ripyetur nga Komisioni nëpërmjet pyetësorit nr. 2 dhe, në përgjigje, ka deklaruar se kishte qenë në pritje që shoqëritë e sipërcituara t’i vinin në dispozicion dokumentacionin e kërkuar. Sipas shpjegimeve të tij, nga kërkimet e kryera dhe përgjigjet e marra prej këtyre shoqërive, për shkak të kohës së gjatë të kaluar, nuk janë gjetur fatura apo situacione të ruajtura që i përkasin periudhës përkatëse.
49. Në lidhje me mënyrën e kryerjes së pagesave ndërmjet palëve, subjekti ka deklaruar se, sipas shpjegimeve të dhëna nga shoqëritë, detyrimet janë shlyer në vijimësi, rast pas rasti, duke theksuar gjithashtu se marrëdhënia tregtare ndërmjet tyre ka vijuar edhe në periudhën aktuale. Subjekti ka pretenduar se ndodhet në pamundësi objektive për të vënë në dispozicion dokumentacionin e kërkuar, për të cilin nuk ka pasur dijeni dhe për administrimin e të cilit nuk ka qenë përgjegjës.
50. Në cilësinë e provës, subjekti ka depozituar shkresën e datës 29.06.2019, të lëshuar nga shoqëria “{***}” ShPK. Shoqëria “{***}” ShPK ka informuar⁹ se pagesa për punimet e kryera ishte dakordësuar në vlerën prej 94.000 eurosh ose nëpërmjet kalimit në pronësi të dy apartamenteve me sipërfaqe 116 m² secili, të vlerësuar në shumën prej 47.000 eurosh secili. Në lidhje me kërkesën e Komisionit për vënien në dispozicion të faturave apo situacioneve të punimeve, shoqëria ka deklaruar se nuk i disponon më këto dokumente për shkak të kalimit të afatit 10-vjeçar të ruajtjes së dokumentacionit kontabël, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.
51. Komisioni i ka kërkuar informacion DRT-së Elbasan mbi marrëdhënien tregtare ndërmjet shoqërisë “{***}” ShPK dhe shoqërisë “{***}” ShPK, duke kërkuar vënien në dispozicion të librave të shitjeve të shoqërisë “{***}” ShPK për periudhën 2006–2008, si dhe aktkontrollet e ushtruara ndaj këtij subjekti tregtar për të njëjtën periudhë. Në përgjigje të kësaj kërkesë, DRT-ja Elbasan¹⁰ përcolli librin e shitjeve të shoqërisë për muajin dhjetor 2007, në të cilin shoqëria “{***}” ShPK nuk rezultonte si blerëse, ndërsa për vitin 2008 nuk u përcoll informacion. Gjithashtu, nga dokumentacioni i administruar, Komisioni konstatoi se shtetasi i ndjerë Sh. I. nuk figuronte në listën e personave të punësuar pranë shoqërisë “{***}” ShPK.
52. Nga informacioni i të dhënave të QKB-së¹¹, rezulton se shtetasi i ndjerë Sh. I. nuk figuronte i regjistruar në regjistrin tregtar. Ndërkohë, ISSh-ja¹² ka përcjellë të dhëna lidhur me historikun

⁹ Sikurse edhe në shkresën e datës 28.6.2021, drejtuar Komisionit, protokolluar me nr. {***} prot., datë 30.06.2021.

¹⁰ Shkresë nr. {***}, datë 09.06.2021.

¹¹ Shkresë nr. {***} prot., datë 13.01.2021.

¹² Shkresë nr. {***} prot., datë 21.01.2021, nga Drejtoria e Arkivit Qendror Lundër.

e punësimit të tij deri në vitin 1983, sipas të cilave ai figuronte me profesion elektrikist. Referuar ekstraktit historik të shoqërisë “{***}” ShPK, me NIPT {***}, rezulton se kjo shoqëri është themeluar më datë 9.10.2007 dhe regjistruar më datë 11.10.2007, datë që përkon edhe me nënshkrimin e aktmarrëveshjes. Shtetasi Sh. P. figuron administrator dhe ortak i vetëm i kësaj shoqërie, me 100% të pjesëve të kapitalit.

53. Referuar përmbajtjes së aktmarrëveshjes së lidhur në datën 11.10.2007, Komisioni ka konstatuar se në këtë akt është përcaktuar numri i pasurisë së apartamentit që do të përfitohej dhe, në lidhje me këtë rrethanë, ka pyetur subjektin gjatë hetimit administrativ. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se, sipas dijenisë së tij dhe informacionit të marrë nga familjarët, si dhe sipas deklaramit të bërë nga përfaqësuesi i shoqërisë “{***}” ShPK në deklaratën noteriale nr. {***}, datë 02.07.2021, apartamenti i përfituar nga vjehri i tij është marrë në objektin ku janë kryer punimet elektrike.
54. Nga dokumentacioni i administruar nga sistemi multifunksional i ASHK-së, rezulton se objekti ku ndodhet apartamenti i përfituar nga subjekti është pajisur me leje ndërtimi nr. {***}, datë 22.04.2005, miratuar me vendimin nr. {***}, datë 6.02.2004, të kryetarit të Komunës Farkë. Referuar aktkolaudimit të depozituar, punimet kanë filluar në muajin maj 2006 dhe kanë përfunduar në shkurt 2008. Akti teknik nr. {***}, “Për zbatimin e detyrave të lëna dhe lejimin e shfrytëzimit të objektit”, mban datën 13.03.2008, ndërsa leja e shfrytëzimit të pallatit është lëshuar më datë 04.09.2008.
55. Komisioni, duke iu referuar legjislacionit përkatës në fushën e ndërtimeve, ka vlerësuar se numri i pasurisë përcaktohet vetëm pasi depozitohen dokumentet përkatëse, ndër të cilat aktkolaudimi, situacioni përfundimtar i punimeve dhe aktet teknike, e më pas lëshohet leja e shfrytëzimit/përdorimit të objektit për regjistrimin në ZVRPP. Sipas Komisionit, fakti që aktmarrëveshja e datës 11.10.2007, përmban të përcaktuar numrin e pasurisë së apartamentit që do të përfitohej, nënkupton se objekti duhej të ishte regjistruar më parë në ZVRPP, ndërkohë që leja e shfrytëzimit rezulton të jetë lëshuar vetëm më datë 04.09.2008.
56. Në këtë kuadër, Komisioni ka vlerësuar se parashikimi i numrit të pasurisë që në datën 11.10.2007, nuk duket të ketë qenë i mundur, pasi bie në kundërshtim me legjislacionin dhe procedurat në fuqi në atë kohë, për sa kohë aktkolaudimi duhet të përfshijë të gjitha punimet e kryera, përfshirë edhe ato elektrike, si dhe situacionin përfundimtar të punimeve, përpara kryerjes së procedurave për lëshimin e lejes së shfrytëzimit/përdorimit dhe regjistrimit të objektit, proces ky që përcakton edhe numrin unik të pasurisë. Për sa më sipër, Komisioni ka ngritur dyshime lidhur me momentin e përpilimit, vërtetësinë dhe ekzistencën e kësaj aktmarrëveshjeje që në vitin 2007, si dhe mbi mënyrën e përfitimit të kësaj pasurie nga subjekti i rivlerësimit.
57. Me rezultatet e hetimit administrativ, subjektit të rivlerësimit i është kaluar barra e provës, pasi Komisioni ka vlerësuar se:
 - 57.1. Nuk provohet që apartamenti në pronësi të subjektit është përfituar nga i ndjeri Sh. I., vjehri i subjektit, për shkak se:

- i. Krijohen dyshime mbi vërtetësinë e aktmarrëveshjes së paraqitur, pasi në datën e lidhjes së saj, më 11.10.2007, është përcaktuar numri i pasurisë së paluajtshme, ndërkohë që dokumentacioni i nevojshëm për regjistrimin përfundimtar të pasurisë në regjistrat publikë, që mundëson përcaktimin e numrit unik të pasurisë, është lëshuar në një moment të mëvonshëm, konkretisht më datë 10.11.2010, sipas kartelës së pasurisë¹³.
- ii. Në kontratën e shitblerjes nuk është pasqyruar se përfitimi i apartamentit ka ardhur si rezultat i aktmarrëveshjes së lidhur në vitin 2007.
- iii. Nuk provohet ekzistenca e një marrëdhënieje tregtare ndërmjet shtetasit Sh. I. dhe shoqërisë “{***}” ShPK, nga njëra anë, dhe shoqërisë “{***}” ShPK, nga ana tjetër.
- iv. Nuk provohet përfitimi i një apartamenti tjetër nga shtetasi Sh. P., një prej palëve sipërmarrëse sipas aktmarrëveshjes së datës 11.10.2007.
- v. Mënyra e përfitimit të kësaj pasurie nuk rezulton në përputhje me dispozitat e Kodit Civil mbi trashëgiminë, pasi e drejta e trashëgimit të shtetasit të ndjerë Sh. I. u takon bashkëshortes dhe fëmijëve të tij, në pjesë të barabarta.
- vi. Në deklaratën periodike të interesave privatë për vitin 2012, subjekti nuk ka pasqyruar në mënyrë të plotë aktin juridik mbi bazën e të cilit pretendon se ka përfituar këtë pasuri.

57.2. Ekzistojnë mospërputhje ndërmjet deklarimeve të subjektit, i cili ka pretenduar se nuk ka paguar asnjë shumë monetare për apartamentin me sipërfaqe 116 m², në {***}, Tiranë, dhe dokumentacionit të administruar, pasi:

- a) në kontratën e shitblerjes parashikohet se është likuiduar e gjithë shuma prej 48.000 eurosh;
- b) shtetasi R. Z. ka deklaruar se diferenca prej 1.000 eurosh lidhet me kryerjen e punimeve shtesë jashtë projektit fillestar.

57.3. Për pasojë, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur rezultojnë në mungesë të burimeve të ligjshme financiare për përfitimin e këtij apartamenti, për sa kohë nuk provohet mënyra e ligjshme e përfitimit të kësaj pasurie.

- 58.** Në shpjegimet e dhëna mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka mbajtur të njëjtin qëndrim si gjatë hetimit administrativ, ashtu edhe në ankimin e paraqitur prej tij, të analizuar në vijim.
- 59.** Kjo aktmarrëveshje porosie nuk rezulton të jetë referuar në kontratën e shitblerjes, nëpërmjet së cilës subjekti i rivlerësimit ka fituar titullin e pronësisë mbi këtë apartament. Po ashtu, edhe në DIPP-në e vitit 2012, ndonëse subjekti ka deklaruar: *Banesë 116 m² në {***}, Tiranë, përfituar nga babai i bashkëshortes, Sh., vlera 48.000 euro*, nuk rezulton të ketë deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie, si dhe nuk ka referuar ekzistencën e aktmarrëveshjes së vitit 2007.
- 60.** Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë me dokumentacion ligjor, të tillë si: fatura, situacione punimesh apo rakordime financiare, së pari, ekzistencën e marrëdhënies së pretenduar të vjehrrit të tij. Aktmarrëveshja e vitit 2007, e paraqitur nga

¹³ Sipas shkresës nr. {***} prot., datë 8.11.2016.

subjekti për herë të parë pranë ILDKPKI-së në muajin shkurt 2016, nuk mbështetet nga prova të tjera të besueshme që provojnë ekzistencën dhe ekzekutimin e marrëdhënies tregtare ndërmjet të ndjerit Sh. I., shoqërisë “{***}” ShPK dhe shoqërisë “{***}” ShPK. Po ashtu, mungon edhe dokumentacioni provues që të vërtetojë qoftë edhe ekzistencën e një marrëdhënieje punësimi të vjehrrit të subjektit me ndonjërin prej këtyre dy shoqërive tregtare.

61. Në mungesë të provave që të konfirmojnë ekzistencën e marrëdhënies tregtare dhe kryerjen e shërbimeve të pretenduara, pretendimet për pagesë në natyrë nëpërmjet përfitimit të një pasurie të paluajtshme, si në rastin konkret, mbeten në nivel deklarativ.
62. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se dokumentacioni mbështetës, si: faturat, situacionet apo aktrakordimet ndërmjet palëve, nuk mund të paraqitet për shkak të kalimit të afatit 10-vjeçar të ruajtjes, trupi gjykues vlerëson se ai rezulton i pambështetur pasi, së pari, vetë subjekti i rivlerësimit ka paraqitur aktmarrëveshjen e vitit 2007, e cila po ashtu i përket një periudhe që tejkalon afatin 10-vjeçar, por që pretendohet të jetë ruajtur dhe zbatuar nga palët. Së dyti, dokumentacioni i kërkuar nga Komisioni lidhet me akte që, sipas legjislacionit përkatës, kanë qenë të detyrueshme të krijoheshin, administroheshin dhe depozitoheshin pranë organeve tatimore, si: faturat e shitjes, situacionet apo aktrakordimet, të cilat duhet të pasqyroheshin në dokumentacionin financiar të shoqërive përkatëse në formën e shpenzimeve të kryera ose të përfitimeve që rridhnin nga marrëdhënia tregtare.
63. Nga ana tjetër, në kundërshtim me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se ndodhet në kushtet e pamundësisë për paraqitjen e dokumentacionit ligjor të shoqërive, për shkak të kalimit të afatit 10-vjeçar të ruajtjes së tyre, rezulton se DRT-ja Elbasan, nëpërmjet shkresës së dërguar pranë Komisionit, ka përcjellë dokumentacion dhe të dhëna në lidhje me shitjet e shoqërisë “{***}” ShPK për muajin dhjetor 2007, nga të cilat rezulton se shoqëria “{***}” ShPK nuk figuron në cilësinë e blerësit.
64. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se nuk ndodhemi përpara kushteve të nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ku subjekti i rivlerësimit gjendet në pamundësi objektive për të paraqitur dokumentacion provues, por përpara mungesës së të dhënave që të provojnë ekzistencën dhe zbatimin e marrëdhënies tregtare të pretenduar. Në kushtet e mungesës së dokumentacionit ligjor provues mbi punimet e kryera, mungesës së faturave për vlerën e shitjes së mallrave në librin e shitjeve të vitit 2007, si dhe për sa kohë librat e shitjeve për vitin 2008 nuk rezultojnë të depozituara pranë organeve kompetente, deklarata noteriale nr. {***}, datë 15.03.2016, e lëshuar nga shtetasi Sh. P., ka vlerë të kufizuar provuese në drejtim të ekzistencës së marrëdhënies tregtare të pretenduar.
65. Ndërkohë, lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se ka paraqitur prova mbi xhiron vjetore të shoqërisë “{***}” ShPK për vitin 2008, trupi gjykues vlerëson se kjo provë, e cila nuk rezulton e depozituar pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan dhe nuk shoqërohet me fatura për shërbime apo mallra të shitura në drejtim të shoqërisë “{***}” ShPK, nuk arrin të provojë ekzistencën e një marrëdhënieje tregtare ndërmjet këtyre subjekteve.
66. Trupi gjykues e vlerëson të drejtë konkluzionin e Komisionit se fakti që aktmarrëveshja e paraqitur nga subjekti, e nënshkruar më datë 11.10.2007, përmban të përcaktuar numrin e pasurisë nr. {***}, z. k. {***}, që ajo duhet ta kishte pasi të regjistrohej në regjistrat publikë,

pas përfundimit të punimeve ndërtimore, ndërkohë që nga aktet e administruara rezultojnë se në atë periudhë, godina ku ndodhet apartamenti objekt shqyrtimi nuk kishte përfunduar ende¹⁴, e bën të pabesueshme këtë aktmarrëveshje. Subjekti i rivlerësimit nuk e ka kundërshtuar në ankim këtë konstatim të Komisionit.

67. Lidhur me sa më sipër, trupi gjykues mori në analizë dokumentacionin e administruar në sistemin multifunksional të ASHK-së Tiranë, nga i cili konstatoi se dokumentacioni për regjistrimin pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, është depozituar më datë 20.09.2008. Nga analiza e këtij dokumentacioni, rezultojnë se procedura për regjistrimin e pasurisë ka filluar pas përfundimit të punimeve, në muajin mars 2008, dhe se dokumentacioni përkatës është paraqitur jo për efekt të regjistrimit provizor të objektit në fazën e karabinasë, por për regjistrimin e objektit të përfunduar, çka ka sjellë regjistrimin e tij pranë organit kompetent të regjistrimit të pasurive.
68. Në këto kushte, numri unik i identifikimit të pasurisë nuk mund të ishte i njohur në vitin 2007, në kohën kur pretendohet të jetë nënshkruar aktmarrëveshja. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit se regjistrimi është kryer paraprakisht, nuk gjen mbështetje në faktet dhe provat e administruara.
69. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se kontrata nuk reflekton aktmarrëveshjen për shkak se shoqëria “{***}” ShPK duhej të paguante tatimin në burim për të ardhurat e realizuara nga shërbimet e kryera prej vjehrrit të tij për punimet elektrike, trupi gjykues konstatoj se, referuar përmbajtjes së vetë aktmarrëveshjes, detyrimi dhe përgjegjësia për shlyerjen e detyrimeve fiskale ndaj shtetit u përkasin sipërmarrësit, në këtë rast shoqërisë “{***}” ShPK dhe z. Sh. I.
70. Po ashtu, trupi gjykues vëren se, referuar aktmarrëveshjes në fjalë, likuidimi i pagesës për punimet e kryera, është parashikuar të realizohet nëpërmjet kalimit në pronësi të “dy apartamenteve me sipërfaqe 116 m²”, për të cilat palët kanë rënë dakord të vlerësohen në shumën 47.000 euro secili. Në aktmarrëveshje parashikohet gjithashtu se porositësi *në përfundim të kryerjes së punimeve, të kryejë procedurat ligjore për kalimin e pronësisë së apartamenteve nr. pasurie {***}, ZK {***}, Tiranë, me sipërfaqe 116 m², në pronësinë e sipërmarrësve, pra shoqërisë “{***}” ShPK dhe shtetasit Sh. I.*
71. Në këtë kuadër, rezultojnë se sipërfaqja që do t’u vihej në dispozicion sipërmarrësve, ishte 116 m², parashikim ky që reflektohet edhe në deklaratën noteriale nr. {***}, datë 15.03.2016, të shtetasit Sh. P., i cili ka deklaruar: “për punimet e kryera do të merrnim si shpërblim nga shoqëria “{***}” ShPK, sipërfaqe ndërtimore të pallati që po ndërtohej dhe, për këtë, na është vënë në dispozicion sipërfaqe ndërtimore 116 m²”. I njëjti qëndrim konfirmohet edhe nga deklarata noteriale nr. {***}, datë 15.03.2016, e znj. T. I., vjehrra e subjektit të rivlerësimit, e

¹⁴ Nga dokumentacioni në sistemin multifunksional të ASHK-së, rezultojnë se objekti ku ndodhet apartamenti i përfunduar nga subjekti, është pajisur me “Leje ndërtimi nr. {***} datë 22.04.2005, miratuar me vendimin nr. {***}, datë 06.02.2004, të kryetarit të Komunës Farkë, bazuar në aktkolaudimin e dorëzuar, punimet kanë filluar në maj të vitit 2006 dhe kanë përfunduar në shkurt të vitit 2008. Akti teknik nr. {***}, “Për zbatimin e detyrave të lëna dhe lejimin e shfrytëzimit të objektit”, mban datën 13.03.2008 dhe leja e shfrytëzimit të këtij pallati është lëshuar në datën 04.09.2008.

cila ka deklaruar se “për punimet që do të kryenin, do të merrnin si shpërblim nga shoqëria “{***}” ShPK një hyrje apartament me sipërfaqe 116 m² në pallatin që do të ndërtohej”.

72. Ndërkohë, shoqëria “{***}” ShPK, nëpërmjet shkresës nr. {***} prot., datë 30.06.2021, me objekt “Kthim përgjigjeje, shoqëruar me dokumentacion”, ka informuar se “pagesa për punimet është dakordësuar për vlerën 94.000 euro ose kalimi në pronësi i dy apartamenteve përkatësisht nga 116 m², në vlerën 47.000 euro secili”.
73. Sa më sipër, në vlerësimin e trupit gjykues, ekziston mospërputhje midis parashikimeve të aktmarrëveshjes së vitit 2007 dhe deklarimeve të z. Sh. P. dhe znj. T. I., të cituara më sipër, duke bërë jobindëse pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me mënyrën e ekzekutimit të marrëdhënies ndërmjet shoqërisë “{***}” ShPK, shoqërisë “{***}” ShPK dhe z. Sh. I.
74. Rezulton se kontrata e shitblerjes e vitit 2012 jo vetëm që nuk i referohet aktmarrëveshjes së vitit 2007, por nuk pasqyron as ekzistencën e marrëdhënies së pretenduar midis palëve. Nga mënyra se si pretendohet të jetë finalizuar kjo marrëveshje, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka përfituar të gjithë sipërfaqen prej 116 m², e cila korrespondon me të gjithë vlerën e punimeve në shumën 94.000 euro dhe jo vetëm me vlerën 47.000 euro, sikurse do të rezultonte nga përmbajtja e aktmarrëveshjes dhe deklaratat noteriale të sipërcituara, pasi nuk provohet që shoqëria “{***}” ShPK të ketë përfituar në pronësi ndonjë apartament banimi, sikurse ka përfituar subjekti i rivlerësimit.
75. Gjithashtu, konstatohet se nga koha e lidhjes së aktmarrëveshjes, e pretenduar në vitin 2007, deri në nënshkrimin e kontratës së shitblerjes në vitin 2012, ka kaluar një periudhë e konsiderueshme kohore, megjithëse ndërtimi i objektit ka përfunduar në muajin mars 2008, ndërkohë që nuk rezulton që shtetasi Sh. I., gjatë kohës së jetës së tij¹⁵, të ketë kryer veprime për realizimin e të drejtave që pretendohet se i rridhnin nga puna e kryer, minimalisht duke poseduar apartamentin objekt kontrolli.
76. Ndërkohë, në vitin 2010, shoqëria “{***}” ShPK ka përfunduar regjistrimin e apartamentit në emër të saj dhe që në atë moment duhet të kryente veprime konkrete për përmbushjen e detyrimeve nga marrëveshja e pretenduar e vitit 2007 në favor të palëve “{***}” ShPK dhe trashëgimtarëve të të ndjerit Sh. I.
77. Fitimi i pronësisë nga subjekti ka ndodhur në vitin 2012, nëpërmjet kontratës së shitblerjes ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë “{***}” ShPK, në të cilën nuk referohet aktmarrëveshja e vitit 2007.
78. Gjatë procesit në Komision, subjekti ka deklaruar se nuk ka bërë asnjë pagesë për apartamentin, ndërkohë që çmimi në kontratën e shitjes është 48.000 euro dhe jo sa çmimi prej 47.000 eurosh i vendosur në aktmarrëveshjen e vitit 2007. Shtetasi R. Z. ka deklaruar se diferenca prej 1.000 eurosh lidhet me kryerjen e punimeve shtesë jashtë projektit fillestar.
79. Në kushtet kur Komisioni nuk ka konsideruar të besueshme aktmarrëveshjen e vitit 2007, pretendimet e subjektit lidhur me pagimin e detyrimeve tatimore nuk kanë ndikim në zgjidhjen e çështjes.

¹⁵ Referuar certifikatës së vdekjes, Sh. I. ka ndërruar jetë më 20.05.2009.

80. Në përfundim të analizës së mësipërme, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë me dokumentacion ligjor dhe prova bindëse ekzistencën dhe ekzekutimin e marrëdhënies juridike mbi të cilën ai pretendon se është krijuar e drejta për përfitimin e apartamentit objekt shqyrtimi. Aktmarrëveshja e datës 11.10.2007, e paraqitur si burimi i krijimit të kësaj pasurie, rezulton e pambështetur nga dokumentacioni financiar dhe tregtar që do të duhej të ekzistonte në rast të kryerjes së punimeve dhe ekzekutimit të marrëdhënies së pretenduar ndërmjet palëve. Për më tepër, mospërputhjet e konstatuara ndërmjet përmbajtjes së aktmarrëveshjes, deklarimeve noteriale të paraqitura në funksion të saj, kontratës së shitblerjes së vitit 2012 dhe të dhënave të administruara nga organet publike nuk krijojnë bindjen se mënyra e pretenduar e krijimit të kësaj pasurie është provuar në nivelin e kërkuar nga ligji.
81. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie dhe as mënyrën e ligjshme të përfitimit të saj. Për rrjedhojë, u gjet i drejtë konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm dhe të mungesës së burimeve financiare të ligjshme për justifikimin e kësaj pasurie në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.
- *Lidhur me depozitën bankare në bankën BKT, me vlerë 128.000 lekë:*
82. Në lidhje me këtë pasuri, Komisioni ka vlerësuar se: *pavarësisht se subjekti gjendet në pamundësi financiare për shumën 82.080 lekë për krijimin e kësaj depozite, kjo mungesë e burimeve të ligjshme që ka shërbyer për krijimin e kësaj depozite, e vetme, nuk është e tillë për t’u renditur si pamjaftueshmëri që çon në shkarkimin e subjektit të rivlerësimit sipas pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*
83. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Depozitë bankare BKT në emër të Erion Çelaj, nr. llogarie {***}, së bashku me shtesat nga interesat bankarë në vite. Data e depozitimit të shumës fillestare 03.03.2009, të përfituar nga kursimet familjare.*
84. Në DIPP-në e vitit 2008, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Depozitë bankare në BKT, në shumën 100.000 lekë, burimi i krijimit kursime familjare.*
85. Subjekti i rivlerësimit e ka kundërshtuar këtë vlerësim të Komisionit duke pretenduar se ka pasur burime financiare të mjaftueshme për krijimin e saj dhe se ka arritur të provojë të kundërtën e barrës së provës. Sipas subjektit, mundësia e tij për kursim deri në datën e krijimit të depozitës, 03.03.2009, rezulton pothuajse e njëjtë me shumën prej 100.000 lekësh. Subjekti pretendon se gabimisht e ka deklaruar këtë depozitë në DIPP-në e vitit 2008, ndërkohë që duhet ta kishte deklaruar në DIPP-në e vitit 2009.
86. Në lidhje me këtë shkak ankimi, nga vendimi objekt kontrolli, rezulton se Komisioni mungesën e burimeve financiare të ligjshme të subjektit lidhur me këtë pasuri, nuk e ka konsideruar ndër arsytet mbi të cilat është bazuar vendimi për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Për rrjedhojë, shqyrtimi i mëtejshëm i këtij pretendimi do të ishte pa ndikim në vendimmarrjen lidhur me zgjidhjen përfundimtare të çështjes ndaj, për arsye të ekonomisë gjyqësore, pretendimi i subjektit u pranua si i drejtë nga trupi gjykues, pa qenë nevoja e një arsyetimi të mëtejshëm.

➤ Lidhur me depozitën bankare në vlerën 3.919 USD, në emër të vajzës, si dhe depozitën bankare në vlerën 3.919 USD, në emër të djalit të subjektit të rivlerësimit:

87. Lidhur me këtë pasuri, Komisioni ka vlerësuar se: *subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë mungesë dokumentacioni ligjor justifikues për krijimin e depozitave bankare në vlerën 7.838 USD, duke u gjendur në kushtet e germës “b” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.*
88. Këtë vlerësim, Komisioni e ka bazuar në vlerësimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë me dokumentacion ligjor se personi tjetër i lidhur A. I. (vëllai i bashkëshortes) ka punuar në Itali dhe ka realizuar të ardhura nga puna e tij dhe, për pasojë, të ardhurat e pretenduara se kanë shërbyer për krijimin e këtyre dy llogarive bankare, nuk janë konsideruar në analizën financiare si burime të ligjshme, në kuptim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
89. Subjekti i rivlerësimit e ka kundërshtuar në ankim këtë vlerësim të Komisionit si të gabuar, duke pretenduar se, për sa kohë kunati i tij kishte dalë nga Shqipëria në mënyrë të parregullt, jashtë pikave të kalimit kufitar, si dhe nuk kishte pasur leje qëndrimi dhe leje pune në Itali, Komisioni duhej të vlerësonte se ankuesi ndodhej në pamundësi objektive për të paraqitur dokumentacionin që justifikonte krijimin e këtyre depozitave, në kuptim të nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.
90. Subjekti ka pretenduar gjithashtu se konstatimet e Komisionit, bazuar në parimin proporcionalitetit, nuk mund të ngrihen në nivelin e një shkak shkakimi në kuadër të vlerësimit të kriterit të pasurisë.
91. Lidhur me këtë shkak ankimi, trupi gjykues, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të Komisionit në raport me arsyetimin e vendimit objekt kontrolli dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, konstaton si vijon.
92. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:
- Depozitë bankare në BKT, në emër të S. Ç., me numër llogarie {***}, së bashku me shtesat nga interesat bankarë në vite. Data e depozitimit të shumës fillestare 03.03.2009, të ardhura që u janë dhuruar fëmijëve, dërguar dorazi nga daja i tyre A. I., për të hapur depozitë në emër të fëmijëve. Këto të ardhura janë përfituar prej tij nga puna gjatë kohës së emigracionit në Itali.
 - Depozitë bankare në BKT, në emër të J. Ç., me numër llogarie {***}, së bashku me shtesat nga interesat bankarë në vite. Data e depozitimit të shumës fillestare 03.03.2009, të ardhura që u janë dhuruar fëmijëve, dërguar dorazi nga daja i tyre A. I., për të hapur depozitë në emër të fëmijëve. Këto të ardhura janë përfituar prej tij nga puna gjatë kohës së emigracionit në Itali
93. Subjekti i rivlerësimit i ka deklaruar këto depozita edhe në DIPP-në e vitit 2008.
94. Së bashku me deklaratën *vetting*, subjekti ka paraqitur dokumentacion justifikues¹⁶ dhe deklaratën noteriale nr. {***}, datë 23.01.2017, të personit tjetër të lidhur A. I., i cili deklaronte se, në periudhën janar-shkurt 2009, u ka dërguar nipit J. dhe mbesës S. shumën prej 6.000 eurosh, nga 3.000 euro secilit, shumë e sjellë dorazi për hapjen e një depozite bankare për

¹⁶ Vërtetim nr. {***} prot., datë 24.10.2016, nga BKT; vërtetim nr. {***} prot., datë 18.10.2016, nga BKT; vërtetim nr. {***} prot., datë 18.10.2016, nga BKT; deklaratë noteriale nr. {***}, datë 23.01.2017, nga shtetasi A. I.

secilin prej tyre, dhe se kjo shumë monetare është siguruar nga puna e tij në emigracion, në Itali.

95. Për të provuar burimin e krijimit të këtyre depozitave, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në cilësinë e provës dokumentin “Deklaratë page”, datë 10.01.2017, të lëshuar nga shoqëria “{***}”, sipas të cilit shtetasi A. I. ka punuar pranë kësaj shoqërie nga data 01.03.2007 deri më 15.10.2011, me pagë mujore në vlerën 1.580 euro.
96. Gjatë hetimit administrativ¹⁷, subjekti ka sqaruar se shuma monetare e dhuruar është siguruar nga puna e kryer nga kunati i tij në emigracion në Itali, si dhe nga të ardhura të tjera të realizuara prej tij dhe familjarëve. Sipas subjektit, kunati i tij A. I., gjatë qëndrimit në Itali si emigrant ekonomik, ka punuar pranë kësaj shoqërie edhe pse nuk ka pasur dokumentacion të rregullt qëndrimi në shtetin italian dhe, për këtë arsye, nuk ka pasur mundësi të deklarohej pranë organeve përkatëse për punën e kryer. Sipas subjektit, të ardhurat e realizuara prej tij janë dërguar herë pas here në Shqipëri nëpërmjet personave të njohur.
97. Nga verifikimet e kryera në sistemin TIMS, Komisionit i ka rezultuar se shtetasi A. I. ka dalë për herë të parë nga territori shqiptar më datë 15.09.2011. Ndërkohë, referuar të dhënave të regjistrimit të gjendjes civile për vitin 2008, rezulton se në përbërjen familjare të të ndjerit Sh. I., figuron shtetasi E. I., i cili ka të njëjtin mbiemër, atësi, mëmësi dhe datëlindje me shtetasin A. I. Sipas të dhënave të sistemit TIMS, shtetasi E. I. ka dalë nga territori shqiptar më datë 22.01.2008, nëpërmjet pikës kufitare të Kakavijës, dhe nuk rezulton të ketë të dhëna të tjera për hyrje apo dalje të mëvonshme.
98. Bazuar në situatën e mësipërme faktike, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk provojnë ligjshmërinë e burimit të krijimit të këtyre pasurive, në përputhje me nenin 32, pikën 4 të ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte, referuar kërkesave të ligjit dhe jurisprudencës së Kolegjit¹⁸, trupi gjykues vlerëson se të ardhurat e pretenduara, të realizuara nga punësimi informal, nuk mund të konsiderohen si të ardhura të ligjshme për efekt të këtij procesi, pasi ato nuk përmbushin standardin e përcaktuar në pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
99. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ndodhet në kushtet e nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pasi nuk gjendet në pamundësi objektive për të paraqitur dokumentacion justifikues, për shkak se, nisur nga natyra informale e qëndrimit dhe punësimit të pretenduar të personit tjetër të lidhur në Itali, një dokumentacion i tillë nuk ka ekzistuar ndonjëherë.
100. Lidhur me zbatimin e parimit të proporcionalitetit, trupi gjykues vlerëson se ky parim mbahet në konsideratë në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë dhe jo duke iu referuar në mënyrë të izoluar vetëm një pasurie të caktuar.
101. Në përfundim të analizës së mësipërme, trupi gjykues e gjen të drejtë vlerësimin e Komisionit se: *subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë mungesë dokumentacioni ligjor justifikues*

¹⁷ Në përgjigjet e pyetësorit standard.

¹⁸ Shih vendimet e Kolegjit: nr. 4, datë 12.02.2019, paragrafi 37.2.2; nr. 6, datë 28.02.2019, paragrafi 20.12; nr. 23, datë 25.09.2020, paragrafi 26.3; nr. 22, datë 22.07.2021, paragrafi 27.4.

për krijimin e depozitave bankare në vlerën 7.838 USD, duke u gjendur në kushtet e germës “b” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

➤ *Në lidhje me automjetin tip “Mercedes-Benz”, me targë {***}, me vlerë 500.000 lekë:*

102. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar në ankim vlerësimin e Komisionit për pasurinë automjet, tip “Mercedes-Benz”, me targë {***}, se: *subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm trajtimin preferencial që kishte pasur për blerjen e këtij automjeti. Komisioni vlerëson se për vetë faktin që shitësi jetonte jashtë dhe kishte sjellë disa herë automjete për t'i shitur, nuk ka pasur arsye për t'ia shitur më lirë, duke mos marrë mbrapsht as kostot e shpenzuara për blerjen dhe transportin e këtij automjeti.*
103. Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur burime financiare të ligjshme për blerjen e automjetit.
104. Vlerësimin e tij Komisioni e ka bazuar në faktin se shitësi i automjetit B. B. ka shpenzuar në total 743.674 lekë për blerjen dhe detyrimet doganore për këtë automjet, ndërkohë që ia ka shitur subjektit të rivlerësimit për çmimin 500.000 lekë.
105. Subjekti i rivlerësimit pretendoi në ankim se, ndonëse Komisioni e ka evidentuar këtë rrethanë si element negativ, nuk ka përcaktuar nëse ky përfundim përbën shkak për përgjegjësi disiplinore dhe, në rast se po, për cilat arsye konsiderohet i tillë.
106. Subjekti pretendoi se, në rastin konkret, nuk ndodhemi përpara një trajtimi preferencial në kuptimin që i jep ligji nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” pasi nuk plotësohen në mënyrë kumulative kushtet e kërkuara nga ligji që një marrëdhënie të cilësohet si e tillë.
107. Ankuesi pretendoi gjithashtu se, për sa kohë nga hetimi administrativ nuk ka rezultuar ekzistenca e ndonjë marrëdhënieje konflikti interesi dhe as që automjeti i është shitur për shkak të detyrës që ushtronte, konkluzioni i arritur nga Komisioni është i pabazuar.
108. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të Komisionit në raport me arsyetimin e vendimit objekt kontrolli dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, konstatoi si vijon.
109. Subjekti i rivlerësimit, në DIPP-në e vitit 2004, ka deklaruar automjetin tip “Mercedes-Benz”, vit prodhimi 1995, me targë {***}, blerë nga shtetasi B. B., në vlerë 500.000 lekë.
110. Në vlerësimin e kësaj pasurie, Komisioni nuk ka referuar se cilat parashikime të nenit D të Aneksit të Kushtetutës apo të ligjit nr. 84/2016 gjejnë zbatim në situatën faktike të konstatuar dhe se problematikat e evidentuara lidhur me këtë pasuri të jenë konsideruar si arsye mbi të cilat është mbështetur dhënia ndaj subjektit të rivlerësimit e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.
111. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerësoi se shqyrtimi i mëtejshëm i këtij pretendimi do të ishte pa ndikim në vendimmarrjen lidhur me zgjidhjen përfundimtare të çështjes ndaj, për arsye të ekonomisë gjyqësore, pretendimi i subjektit u pranua si i drejtë nga trupi gjykues, pa qenë nevoja e një arsyetimi të mëtejshëm.

➤ Në lidhje me automjetin me targë {***}, me vlerë 6.500 euro:

112. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar në ankim vlerësimin e Komisionit se: *subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e automjetit, pasi, nga analiza financiare e datës 11.06.2007, subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me balancë negative në shumën 258.428 lekë, duke u gjendur në kushtet e gurmës “b” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.*
113. Këtë vlerësim, Komisioni e ka bërë në bazë të konstatimit se, referuar kontratës së shitjes nr. {***}, datë 05.05.2007, çmimi i shitjes së automjetit me targë {***}, është përcaktuar në vlerën 200.000 lekë dhe jo 500.000 lekë, sikurse pretendohet nga subjekti i rivlerësimit. Kontrata ka formën e kërkuar nga ligji dhe nuk është goditur për pavlefshmëri, ajo nuk është revokuar apo kundërshtuar nga asnjëra prej palëve. Pretendimet e ngritura nga subjekti, pas shumë vitesh, në lidhje me çmimin real të shitjes së këtij automjeti, nuk mund të ndryshojnë përmbajtjen e aktit noterial të hartuar në vitin 2007.
114. Subjekti i rivlerësimit e ka kundërshtuar vlerësimin e Komisionit duke pretenduar se kontrata e shitjes e vitit 2007 ka një lapsus lidhur me çmimin e shitje të shënuar 200.000 lekë, ndërkohë që çmimi real ka qenë 500.000 lekë.
115. Subjekti ka pranuar në ankim se në deklaratën periodike të vitit 2007, nuk është deklaruar as blerja e automjetit dhe as shitja e automjetit të blerë në vitin 2004 dhe, për pasojë, nuk kishte konstatuar se vlera e shitjes së pasqyruar në kontratën nr. {***}, datë 05.05.2007, nuk përputhej me çmimin real të shitjes së automjetit. Gjatë hetimit administrativ, subjekti ka deklaruar se këtë fakt e ka konstatuar vetëm në momentin kur Komisioni i ka kërkuar të justifikojë burimin e krijimit për blerjen e automjetit në vlerën 6.500 euro po në vitin 2007.
116. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të Komisionit në raport me arsyetimin e vendimit objekt kontrolli dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, konstatoi si vijon.
117. Më datë 11.06.2007, nëpërmjet kontratës nr. {***}, subjekti i rivlerësimit ka blerë automjetin tip “Mercedes-Benz” E220 CDI, viti i prodhimit 2000, në vlerën 6.500 euro. Subjekti nuk e ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2007 blerjen e këtij automjeti¹⁹.
118. Në procesverbalin e mbajtur pranë ILDKPKI-së më datë 26.02.2016, i pyetur lidhur me automjetet që ka poseduar gjatë periudhës 2004-2014, subjekti ka shpjeguar se në vitin 2004 ka deklaruar blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz 250”, viti i prodhimit 1995, të cilin e ka mbajtur për rreth tre vjet dhe, pas shitjes së tij, ka blerë automjetin tjetër me targë {***}, prodhim i vitit 2000. Sipas subjektit, për shkak se vlera e shitjes së automjetit të mëparshëm dhe vlera e blerjes së automjetit të ri kanë qenë të njëjta, deklarimi i këtij veprimi është neglizhuar prej tij, edhe për shkak se periudha e deklarimit përkonte me transferimin e tij nga Fieri në Sarandë. Subjekti ka sqaruar më tej se ka deklaruar me saktësi targat dhe datat e kontratave të shitblerjes dhe se nuk ka pasur asnjë arsye për t’i fshehur apo mos deklaruar ato.
119. Nga dokumentacioni i administruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), ka rezultuar se automjeti me targë {***} dhe automjeti me targë {***}

¹⁹ Të cilit, pas blerjes, i është dhënë targë {***}.

janë shitur dhe blerë, sipas kontratave përkatëse, respektivisht në vlerat 200.000 lekë dhe 6.500 euro.

120. Gjatë hetimit administrativ, i pyetur²⁰ lidhur me burimin e krijimit të automjetit me targë {***}, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se një prej burimeve të krijimit të kësaj pasurie kanë qenë të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit me targë {***}, sipas kontratës nr. {***}, datë 05.05.2007. Subjekti ka shpjeguar se në këtë kontratë, ekziston një gabim material në përcaktimin e vlerës së shitjes së automjetit, pasi çmimi real i shitjes nuk ka qenë 200.000 lekë, por 500.000 lekë, dhe se në momentin e nënshkrimit të kontratës ai nuk i ka kushtuar rëndësi pasqyrimin të kësaj vlere, për sa kohë palët kishin rënë dakord për shumën reale të të hollave të marra nga shitja e automjetit. Sipas subjektit, këto pasaktësi dhe pakujdesi lidhen me kohën kur janë kryer deklarimet. Ai ka sqaruar gjithashtu se si burim tjetër për krijimin e kësaj pasurie, kanë shërbyer edhe kursimet e krijuara deri në momentin e blerjes së automjetit.
121. Trupi gjykues vlerëson se në kuptim të nenit 253 të Kodit të Procedurës Civile, kontrata noteriale është akt zyrtar dhe kundërshtimi i përmbajtjes së saj lidhur me deklarimet e bëra nga palët përpara noterit publik lejohet vetëm në rastet kur pretendohet falsifikimi i saj. Në këto kushte, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se çmimi i shitjes së kësaj pasurie ka qenë 500.000 lekë dhe jo 200.000 lekë, sikurse është përcaktuar nga vetë palët me vullnet të lirë përpara noterit publik, mbetet deklarativ dhe i paprovuar.
122. Për sa më sipër, trupi gjykues e gjeti të drejtë qëndrimin e Komisionit se të ardhurat nga shitja e automjetit me targë {***}, duhen konsideruar, referuar kontratës së shitjes së kësaj pasurie, në vlerën 200.000 lekë.
123. Nga kontrolli i kryer, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, analizës financiare të Komisionit, trupi gjykues konstatoi se konfirmohet konkluzioni i Komisionit për mungesë të burimeve financiare të ligjshme të subjektit të rivlerësimit për blerjen e automjetit me targë {***}, në shumën (-) 258.428 lekë.
124. Duke mbajtur në konsideratë faktin se kjo pasuri nuk ekzistonte më në momentin e plotësimit të deklaratës *vetting*, pasi rezulton të jetë shitur nga subjekti në vitin 2010²¹, trupi gjykues vlerëson se efekti i mungesës së burimeve financiare të ligjshme për krijimin e saj afekton analizën financiare të vitit 2007, periudhë në të cilën kjo pasuri është blerë.
 - Në lidhje me automjetin me targë {***}, në vlerën 980.000 lekë:
125. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar në ankim vlerësimin e Komisionit se: *subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për shumën 182.765 lekë për blerjen e automjetit, duke u gjendur në këto kushte në parashikimet e germës "b" të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.*
126. Këtë vlerësim, Komisioni e ka mbështetur në konstatimin se, për të ardhurat e krijuara nga diferenca ndërmjet çmimit të shitjes dhe atij të blerjes së automjetit me targë {***}, në vlerën 182.765 lekë, nuk është provuar pagesa e detyrimeve tatimore.

²⁰ Me anë të pyetësorit nr. 2, e-mail datë 24.6.2021.

²¹ Sipas kontratës së shitjes nr. {***}, datë 30.04.2010.

127. Subjekti i rivlerësimit e ka kundërshtuar këtë konkluzion të Komisionit, duke pretenduar se ka provuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se dispononte burime të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie. Sipas subjektit, në analizën financiare për krijimin e kësaj pasurie, duhet të merret në konsideratë vlera e plotë e përfutur nga shitja e automjetit me targë {***} në vitin 2010.
128. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të Komisionit në raport me arsyetimin e vendimit objekt kontrolli dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, konstaton si në vijim.
129. Automjeti me targë {***}, i blerë nga subjekti me kontratën nr. {***}, datë 11.06.2007, në vlerën 6.500 euro²², ose 807.235 lekë, është shitur më pas me kontratën nr. {***}, datë 30.04.2010, në vlerën 990.000 lekë.
130. Subjekti ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2011 se si burim financiar për blerjen e automjetit me targë {***}, në vlerën 980.000 lekë, kanë shërbyer të ardhurat e realizuara nga shitja e automjetit me targë {***} në vitin 2010, me çmimin 990.000 lekë.
131. Komisioni nuk i ka konsideruar si të ligjshme të ardhurat e krijuara nga diferenca ndërmjet çmimit të shitjes dhe atij të blerjes, në shumën 182.765 lekë, me arsyetimin se nuk është provuar pagesa e detyrimeve tatimore për këtë të ardhur.
132. Trupi gjykues e vlerësoi këtë qëndrim të Komisionit në raport me legjislacionin e zbatueshëm, sipas të cilit nuk parashikohet shprehimisht detyrimi për pagimin e tatimit mbi diferencën që krijohet ndërmjet çmimit të shitjes dhe atij të blerjes së një pasurie të luajtshme të llojit automjet.
133. Sipas dispozitave kushtetuese dhe interpretimit të tyre nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese²³, përcaktimi i të ardhurave “të tatueshme” nuk është lënë në diskrecion të organeve tatimore, por i është rezervuar vetëm ligjit. Kjo pasi neni 155 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon se taksat, tatimet dhe detyrimet financiare kombëtare e vendore, lehtësimi apo përjashtimi prej tyre i kategorive të caktuara të pagesve, si dhe mënyra e mbledhjes së tyre, caktohen vetëm me ligj.
134. Për këto arsye, trupi gjykues vlerëson se ndryshimi i ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, me ligjin nr. 9161, datë 18.12.2003²⁴, me të cilin në nenin 8, që përcakton të ardhurat e tatueshme, u shtua paragrafi me përmbajtje: “g) të ardhura të tjera, që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen, të realizuara nga individë rezidentë ose nga persona jorezidentë, por me burim në Republikën e Shqipërisë”, nuk mund t’i nënshtrohet një interpretimi të zgjeruar që do të sillte si pasojë përcaktimin e detyrimit për pagesën e tatimit mbi të ardhurat e krijuara nga transaksionet e shitblerjes së automjeteve, në kushtet kur mungon qartësia lidhur me shkallën tatimore, bazën e tatueshme, mënyrën e pagesës dhe agjentin tatimmbledhës.

²² Vlerësuar me kursin zyrtar të këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë, në datën e blerjes, 1 euro = 124,19 lekë.

²³ Në vendimin nr. 16, datë 25.07.2008, të Gjykatës Kushtetuese, është arsyetuar se: “Marrëdhëniet e tatim-taksave janë marrëdhënie ligjore detyrimi ndërmjet shtetit dhe tatimpaguesve dhe si të tilla ato mund të përcaktohen vetëm me ligj”. Shih : https://www.gjk.gov.al/web/Vendime_perfundimtare_100_1.php.

²⁴ Ligji nr. 9161, datë 18.12.2003, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

135. Përveç sa më sipër, trupi gjykues mbajti në konsideratë edhe qëndrimin e mbajtur nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, të pasqyruar në shkresën nr. {***} prot., datë 25.05.2023, përcjellë në përgjigje të kërkesës së Kolegjit për informacion. Në këtë shkresë, ky institucion ka sqaruar se, për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale, neni 8 i ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe udhëzimi nr. 5, datë 30.01.2006, i Ministrisë së Financave, i miratuar në zbatim të tij dhe i ndryshuar ndër vite, nuk kanë përfshirë apo përcaktuar si të ardhura të tatueshme të ardhurat nga shitja e pasurisë së luajtshme për përdorim personal, siç është automjeti.
136. Mbështetur në arsyetimin e mësipërm, trupi gjykues vlerëson se konkluzioni i arritur nga Komisioni lidhur me pasurinë objekt shqyrtimi, i bazuar në faktin se nuk u provua pagesa e detyrimeve tatimore për të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit me targë {***}, është i pabazuar.
137. Për sa më sipër, në ndryshim nga vlerësimi i Komisionit, duke i konsideruar si të ligjshme të ardhurat e krijuara nga shitja e automjetit sipas analizës së bërë më sipër, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit arrin të justifikojë me burime të ligjshme blerjen e automjetit me targë {***}.
- *Lidhur me analizën financiare për periudhën 2003-2016:*
138. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar në ankim, vlerësimin e Komisionit se, pasi kreu analizën financiare për periudhën 2003-2016 se: *subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme në vitin 2007, në vlerën 361.974 lekë për kryerjen e shpenzimeve dhe blerjen e pasurive, duke u gjendur në kushtet e germës “b” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.*
139. Subjekti i rivlerësimit e ka kundërshtuar vlerësimin e mësipërm të Komisionit duke pretenduar se diferenca negative në vitin 2007, vjen për shkak të lapsusit të kryer në kontratën nr. {***}, datë 05.05.2007. Diferenca e vogël, në vlerën 61.974 lekë, nuk mund të konsiderohet si pamjaftueshmëri, në kushtet kur llogaritjet e Komisionit janë hipotetike, mbi bazë të dhënash statistikore dhe jo realiste.
140. Lidhur me këtë shkak ankimi, trupi gjykues, referuar analizës që ka bërë në këtë vendim për të ardhurat e realizuara nga subjekti nga shitja e automjetit në vitin 2007, me çmimin 200.000 lekë dhe jo atë të pretenduar nga subjekti 500.000 lekë, e gjen të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit, duke konfirmuar si të drejtë konkluzionin e Komisionit.
141. Në përfundim të analizës së mësipërme të shkaqeve të ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë, trupi gjykues e gjeti të drejtë vlerësimin e Komisionit se, në kuptim të nenit 59, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga pikat 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe pika 3 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.
- *Lidhur me kriterin e kontrollit të figurës:*
142. Subjekti i rivlerësimit pretendon se në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, Komisioni i ka kërkuar shpjegime, por nuk i ka kaluar barrën e provës. Informacioni i marrë nga DSIK-ja nuk është i bazuar dhe Kolegji duhet të arrijë në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka arritur

një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

143. Trupi gjykues konstaton se Komisioni, në vendimin objekt kontrolli, nuk ka formuluar një përfundim të qartë dhe të argumentuar lidhur me kriterin e kontrollit të figurës, duke mos përcaktuar nëse subjekti i rivlerësimit ka arritur apo jo nivelin e besueshëm të kërkuar nga ligji. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të ngrejë një shkak konkret ankimi lidhur me vlerësimin e këtij kriteri, por ka paraqitur kundërshtimin e tij lidhur me konkluzionin e arritur nga DSIK-ja për papërshtatshmërinë e subjektit për vazhdimin e detyrës.
144. Në kushtet kur vendimi i Komisionit për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nuk është bazuar në gjetje apo konkluzione që lidhen me kriterin e kontrollit të figurës, shqyrtimi i pretendimeve të ngritura në ankim në lidhje me këtë kriter, nuk do të kishte ndikim në zgjidhjen e çështjes. Për arsye të ekonomisë gjyqësore, trupi gjykues vlerësoi se analizimi i tyre ishte i panevojshëm.

➤ ***Lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale:***

145. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka arritur në dy konkluzione kontradiktore sa i takon vlerësimit të aftësive profesionale, pasi nga njëra anë vlerëson se problematikat e evidentuara dhe të shqyrtuara në këtë vendim nuk përmbajnë shkelje serioze dhe nuk kanë shkaktuar pasoja të rënda procedurale për palët, në mënyrë që subjekti i rivlerësimit të kualifikohet “i papërshtatshëm” nga ana profesionale, ndërsa nga ana tjetër, në vlerësimin tërësor të problematikave, në seksionin “Konstatime të tjera”, bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, duke u gjendur në kushtet e pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.
146. Nga analiza e vendimit objekt kontrolli, rezulton se Komisioni, pasi ka administruar raportin e përcjellë nga KLP-ja²⁵, ka kryer procedurën e vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit duke arritur në konkluzionin se: *në vlerësimin tërësor të kriterit të aftësive profesionale, problematikat e evidentuara dhe të shqyrtuara në këtë vendim vlerësohet se nuk përmbajnë shkelje serioze dhe nuk kanë shkaktuar pasoja të rënda procedurale për palët në mënyrë që subjekti i rivlerësimit të kualifikohet “i papërshtatshëm” nga ana profesionale.*
147. Në këto kushte, subjekti nuk ka ngritur ndonjë shkak ankimi konkret lidhur me vlerësimin nga Komisioni të aftësive profesionale.

²⁵ KLP-ja ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit Erion Çelaj shfaq aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në vlerësimet e punës për vitet 2014, 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se subjekti është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë profesionale të tij si në hetimet dhe gjykimet që ka ndjekur personalisht, ashtu edhe në menaxhimin e drejtë dhe në kohë të arsyeshme të shumëllojshmërisë dhe kompleksitetit të çështjeve që ka pasur në ndjekje. Rezulton se për periudhën e rivlerësimit, 8.10.2013 – 8.10.2016, subjekti ka trajtuar gjithsej 587 çështje, nga të cilat për 194 çështje është vendosur mosfillimi, 57 çështje janë pushuar, 106 çështje janë dërguar për gjykim dhe 230 çështje janë pezulluar. Subjekti ka treguar aftësi në organizimin efektiv të kohës së punës, ka kryer, drejtuar dhe kontrolluar veprimtarinë hetimore brenda një afati të arsyeshëm në raport me kompleksitetin dhe shumëllojshmërinë e çështjeve.

➤ *Lidhur me cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë:*

148. Subjekti i rivlerësimit kundërshton në ankim konkluzionin e Komisionit për cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, duke pretenduar se kjo gjetje nuk është përfshirë në raportin për rezultatet e hetimit dhe se me të është njohur vetëm nëpërmjet vendimit objekt ankimi. Sipas tij, cenimi i besimit të publikut mund të konstatohet vetëm në kuadër të një vlerësimi tërësor të të tria kritereve të rivlerësimit dhe jo mbi bazën e konstatimeve që lidhen me një kriter të vetëm. Më tej, subjekti pretendon se arsyetimi i Komisionit nuk mbështetet në prova konkrete, por në hamendësime dhe dyshime të paprovuara.

149. Trupi gjykues vëren se, në konkluzionin përfundimtar të seksionit të vendimit mbi “Konstatimet e tjera”, Komisioni, në kuadër të vlerësimit tërësor të problematikave të analizuar dhe bazuar në nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, duke u gjendur në kushtet e pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

150. Në vijim janë analizuar shkaqet e ankimit që ka parashtruar subjekti i rivlerësimit lidhur me këto problematika.

➤ *Lidhur me kontaktet e subjektit të rivlerësimit me shtetasin F. D.:*

151. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar në ankim vlerësimin e Komisionit lidhur me kontaktet me shtetasin F. D. se: *Duke analizuar deklaratimet e subjektit gjatë hetimit, por edhe gjatë seancës dëgjimore, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit: (i) konfirmon se e njej këtë shtetas, por nuk parashtrroi në mënyrë të besueshme se nuk është në dijeni të faktit se personi është i përfshirë në procedime të ndryshme penale; (ii) subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë i hapur, i besueshëm dhe i plotë në lidhje me kontaktet që ka pasur me këtë shtetas, pasi nuk konfirmoi gjatë hetimit udhëtimin që kishte pasur në shoqërinë e këtij shtetasi në Kosovë dhe nuk deklaroi se kishte pasur komunikim telefonik sipas të dhënave të Komisionit; (iii) subjekti i rivlerësimit ka qenë kontradiktor në deklaratimet e tij karshi njohjes me këtë shtetas, fakt i cili Komisionit i krijoi bindjen se subjekti mund të ketë qenë në dijeni të faktit se shtetasin F. D. do të ishte i pranishëm në udhëtimin në Kosovë, çka nuk të krijon bindjen se ky udhëtim ka qenë rastësor, në datën 7.12.2013. Në përfundim, Komisioni vlerëson se konkluzionet e renditura më lart duhet të merren në konsideratë në vlerësimin tërësor, në kuptim të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, për besueshmërinë e deklaratimeve të subjektit dhe pikës 5 të nenit 61, duke cenuar besimin që publiku ka te drejtësia.*

152. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi konkluzionin e Komisionit sipas të cilit ai ka qenë kontradiktor në deklaratimet e tij lidhur me njohjen dhe udhëtimin me shtetasin F. D., duke e cilësuar këtë përfundim si të pabazuar, jologjik dhe kontradiktor. Në këtë drejtim, subjekti parashtrroi këto pretendime:

152.1. Në lidhje me shtetasin F. D., Komisioni nuk ka identifikuar asnjë sjellje të paligjshme apo joetike të subjektit të rivlerësimit në kuadër të vlerësimit të aftësive profesionale. Konkluzioni i Komisionit bazohet në hamendësime, për sa kohë në vendim përdoren shprehje të tilla si “dyshim” dhe “mund”, të cilat tregojnë se vetë Komisioni nuk ka qenë i bindur se subjekti ka qenë në dijeni të faktit që ky shtetas do të ishte i pranishëm në udhëtimin drejt Kosovës.

152.2. Udhëtimi me shtetasin F. D. ka qenë rastësor dhe se ai nuk ka pasur dijeni për ndonjë veprimtari të kundërligjshme të këtij shtetasi në momentin e kryerjes së udhëtimit. Procedimi penal ndaj shtetasit F. D. është regjistruar përpara se ai të emërohej drejtues i prokurorisë, ndërsa procedimi penal i vitit 2014 është regjistruar në një kohë kur ai nuk ushtronte funksionin e drejtuesit të kësaj prokurorie. Për rrjedhojë, subjekti pretendoi se nuk ka qenë ai që ka caktuar prokurorin përgjegjës për ndjekjen penale ndaj këtij shtetasi dhe se nuk ka ushtruar asnjëherë ndjekje penale ndaj tij.

152.3. Subjekti nuk mund të kishte dijeni për procedimet penale të regjistruara nga Prokuroria e Krimeve të Rënda ndaj shtetasit F. D., pasi udhëtimi në fjalë rezulton të jetë kryer në vitin 2013, përpara regjistrimit në Prokurorinë e Shkallës së Parë Vlorë të procedimit penal të vitit 2014 ndaj këtij shtetasi, si dhe përpara regjistrimit të procedimit të bazuar në aktet e përcjella nga Prokuroria e Krimeve të Rënda.

152.4. Komisioni, në vendimmarrjen e tij, ka përdorur si provë përgjime të kryera nga organet ligjzbatuese, duke kryer një shkelje të rëndë procedurale që cenon sigurinë kombëtare. Sipas subjektit, këto përgjime janë kategorikisht të ndaluara të përdoren dhe nuk i janë vënë në dispozicion subjektit të rivlerësimit. Ai argumentoi se përgjimi parandalues rregullohet nga një ligj i posaçëm, i cili përcakton shprehimisht se rezultatet e këtyre përgjimeve nuk mund të përdoren si prova.

152.5. Subjekti i rivlerësimit pretendoi më tej se vetë Komisioni, në përfundim të analizës së fakteve të administruara gjatë hetimit, nuk ka arritur në përfundimin se ai ka qenë në dijeni të ndonjë veprimtarie të paligjshme të shtetasit F. D., nëse një e tillë ka ekzistuar.

153. Trupi gjyqësor, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të Komisionit, si dhe u njoh në mënyrë të drejtpërdrejtë me të njëjtin informacion “sekret shtetëror” me të cilin ishte njohur Komisioni dhe vëzhguesi ndërkombëtar i çështjes, konstaton si vijon.
154. Nga të dhënat e sistemit TIMS, me shkresën nr. {***} prot., datë 31.05.2021, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit, më datë 07.12.2013, ka udhëtuar me automjetin me targë {***}, në pronësi të tij, së bashku me shtetasin F. D. dhe dy shtetas të tjerë²⁶.
155. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, ku subjekti i rivlerësimit ka ushtruar detyrën e drejtuesit dhe më pas atë të prokurorit, ka regjistruar procedimin penal nr. {***}, datë 28.11.2011, ndaj shtetasit F. D. për veprën penale “Mbajtja pa leje e armëve luftarake”. Në përfundim të këtij procedimi, me vendimin nr. {***}, datë 28.02.2012, të Gjykatës së Rrethit Vlorë, shtetasi F. D. është deklaruar fajtor për kryerjen e kësaj vepre penale dhe është dënuar me 200.000 lekë gjobë.

²⁶ Më datë 07.12.2013, nga të dhënat e regjistruara në sistemin TIMS, rezulton i regjistruar udhëtimi me automjetin me targë {***}, i shtetasve F. D., E. B. (anëtar i Dhomës së Avokatisë, avokat mbrojtës i F. D. gjatë gjyqimit të çështjes penale nr. {***}/2011, sipas vendimit nr. {***}, datë 28.02.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë), Erion Çelaj, Sh. S., dhe I. C. (pronar i automjetit BMW të sekuestruar në procedimin penal nr. {***}/2011).

156. Rezulton se gjatë vitit 2014, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë ka zhvilluar hetime ndaj shtetasit F. D. për veprën penale “Kundërshtim i punonjësit të policisë së rendit publik”, të parashikuar nga neni 236/1 i Kodit Penal.
157. Gjithashtu, rezulton se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë ka kryer hetime në kuadër të procedimit penal nr. {***} të vitit 2013, ndaj disa shtetasve shqiptarë, ndër të cilët edhe shtetasi F. D., i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Trafikim i narkotikëve”, kryer në bashkëpunim dhe mbetur në tentativë, të parashikuar nga nenet 283/a, paragrafi i dytë dhe 22 të Kodit Penal.
158. Prokuroria më pas ka ndryshuar akuzën ndaj këtij shtetasi, duke e akuzuar për kryerjen e veprës penale “Moskallëzim krimi”, të parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal. Në përfundim, me vendimin nr. {***}, datë 17.06.2020, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur deklarinim fajtor të shtetasit F. D. për kryerjen e veprës penale “Moskallëzim krimi” dhe dënimin e tij me 1 vit burgim.
159. Përveç të dhënave të sistemit TIMS, Komisioni është njohur edhe me informacion të klasifikuar “sekret shtetëror”, nga i cili ka rezultuar se ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit F. D. kanë ekzistuar komunikime telefonike, si dhe takime para udhëtimit të ndodhur në datën 07.12.2013.
160. Gjatë hetimit administrativ, Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, e ka pyetur subjektin e rivlerësimit nëse ka pasur kontakte me shtetasin F. D., në formën e takimeve, komunikimeve elektronike apo telefonike, si dhe nëse ka udhëtuar ose është shoqëruar ndonjëherë me të.
161. Në përgjigjet e tij, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *Në dijeninë time, shtetasin F. D. e njoh vetëm si pronar të një restoranti në zonën e Radhimës, ku kam shkuar për evente, si: fejesa, dasma apo ditëlindje të personave të njohur, pasi ka qenë një nga lokalet më të frekuentuara të qytetit të Vlorës për aktivitete të tilla. Në dijeninë time, nuk kam pasur ndonjëherë kontakt me të në formën e komunikimeve elektronike apo telefonike, nuk kam udhëtuar dhe as jam shoqëruar me këtë person. Takimet me të kanë qenë vetëm rastësore, në raportin pronar-klient, për ato pak raste kur kam frekuentuar lokalit. Prej shumë vitesh nuk e frekuentoj më këtë ambient dhe nuk kam më dijeni për këtë person.*
162. Bazuar në faktet e rezultuara nga hetimi administrativ, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, duke i kërkuar shpjegime në lidhje me konstatimet se: (i) është shoqëruar me shtetasin F. D., ndonëse ka qenë në dijeni të problemeve të tij me ligjin, ndërkohë që ky i fundit rezulton i proceduar, i dyshuar dhe i dënuar në disa raste; (ii) nuk ka qenë i sinqertë në deklarinimet e dhëna para Komisionit, pasi ka mohuar faktin se ka pasur kontakte me këtë shtetas në formën e takimeve, udhëtimeve apo shoqërimit me të.
163. Në përgjigje të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se udhëtimi me shtetasin F. D. ka qenë një rast sporadik, konkretisht një udhëtim njëditor në Kosovë dhe se, për shkak të kohës së gjatë të kaluar, mbi 7 vjet nga momenti i kryerjes së tij, në kohën kur është pyetur nga Komisioni nuk e kujtonte që në këtë udhëtim kishte qenë i pranishëm edhe shtetasi F. D.
164. Subjekti ka deklaruar se ky udhëtim është kryer në vitin 2013, përpara regjistrimit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë të procedimit penal të vitit 2014, si dhe përpara

procedimit të regjistruar mbi bazën e akteve të përcjella nga Prokuroria e Krimeve të Rënda, për të cilin, sipas tij, nuk ka pasur dijeni.

165. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se ka pranuar dhe deklaruar njohjen me shtetasin F. D. dhe se nuk ka pasur me të marrëdhënie të tjera, përveç atyre të deklaruara gjatë hetimit administrativ dhe, që prej atij momenti e deri në kohën e zhvillimit të procesit të rivlerësimit, nuk ka pasur më kontakte me këtë shtetas.
166. Gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *[...] unë nuk e kam mohuar faktin që e njoh këtë person, ndonëse e kam njohur me një emër tjetër. Për të qenë korrekt, i sinqertë dhe sa më sqarues, dua të them se e kam njohur pasi kam shkuar me punë në qytetin e Vlorës, për shkak se ai ishte pronar i një restoranti që frekuentohej nga shumë persona me integritet, pasi aty organizoheshin ceremoni fejese, dasmash dhe takime të ndryshme. Ky ka qenë momenti i njohjes me këtë person. Sa i takon udhëtimin, nuk kam pasur asnjë arsye për ta fshehur, por bëhet fjalë për një periudhë të largët kohore dhe për një udhëtim sporadik. Nuk e mbaj mend dhe nuk e kujtoj që të kemi qenë në të njëjtën makinë. Unë kam qenë i ftuar bashkë me tre shokë të mi në një festë nga një mik në Prishtinë dhe, duke qenë se një kolegu im shprehu dëshirën që të vinte gjithashtu në këtë udhëtim dhe ai ndodhej me këtë person, nuk mendova se kjo mund të përbënte ndonjë problem. Sinqerisht, nuk e kujtoj që të kemi qenë në të njëjtën makinë. Shpeshherë, gjatë kalimeve kufitare, për shkak të rrëmujës dhe procedurave të ndjekura nga punonjësit e policisë kufitare, ndodh që vulat të mos vendosen ose të ketë pasaktësi në regjistrime [...]. Ndoshta kalimet kanë qenë afër njëri-tjetrit dhe regjistrimi është bërë gabimisht në emër të atij personi. Megjithatë, unë sinqerisht nuk e mbaj mend.*
167. Lidhur me dijeninë e subjektit të rivlerësimit për përfshirjen e shtetasit F. D. në veprimtari të kundërligjshme, trupi gjykues konstaton se të paktën në lidhje me procedimin penal nr. {***}, të regjistruar më 28.11.2011, në prokurorinë e drejtuar prej tij, për veprën penale të “Mbajtjes pa leje të armëve”, subjekti ka pasur dijeni për rrethanat e këtij procedimi. Kjo çështje është hetuar dhe gjykuar gjatë viteve 2011–2012, periudhë në të cilën subjekti ushtronte detyrën e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ndërsa nga aktet e administruara rezulton se ai ka nënshkruar edhe akte procedurale që lidhen me këtë procedim.
168. Nga aktet e çështjes, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e Drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me anë të shkresës nr. {***} prot., datë 13.01.2012, ka përcjellë aktet për gjykimin e procedimit penal nr. {***}/2011 ndaj të pandehurit F. D., për veprën penale “Mbajtja pa leje e armëve”, të parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal.
169. Po ashtu, rezulton se me shkresën nr. {***} prot., datë 13.01.2012, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, i ka kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve certifikatën e gjendjes gjyqësore për të pandehurin F. D., ndërsa me shkresën nr. {***} prot., datë 20.12.2011, ka përcjellë urdhrin e prokurorit të çështjes për kthimin e automjetit të sekuestruar në kuadër të procedimit penal nr. {***}/2011.

170. Nga të dhënat e regjistruara në sistemin TIMS, rezultoi se më datë 07.12.2013, është regjistruar një udhëtim me automjetin me targë {***}, në pronësi të subjektit të rivlerësimit, ku figurojnë si udhëtarë shtetasit F. D., E. B.²⁷, Erion Çelaj, Sh. S. dhe I. Ç.²⁸.
171. Në vlerësim të provave të administruara, trupi gjykues arrin në përfundimin se pretendimi i subjektit të rivlerësimit për një regjistrim të gabuar në sistemin TIMS, nuk qëndron. Rrethanat e udhëtimit dhe lidhjet ndërmjet personave që kanë udhëtuar në të njëjtin automjet përjashtojnë karakterin rastësor të tij, ndërsa të paktën katër prej këtyre personave rezultojnë të kenë pasur lidhje të drejtpërdrejta me procedimin penal nr. {***}/2011 ndaj shtetasit F. D.
172. Komisioni, në pikën 78 të vendimit objekt kontrolli, ka arsyetuar se: *Nga informacionet pranë organeve ligjzbatuese, të cilat nuk bëhen publike pasi janë informacion i klasifikuar “sekret shtetëror”, rezulton se midis subjektit dhe shtetasit F. D. ka pasur edhe komunikime telefonike. Kontaktet telefonike dhe udhëtimi drejt Kosovës, ndonëse kanë ndodhur gjatë kohës që ky shtetas nuk ka qenë në cilësinë e personit të akuzuar, por të një personi të dyshuar për përfshirje në këtë aktivitet, vlerësohen nga Komisioni si rrethana të cilat konfirmojnë se subjekti i rivlerësimit ka qenë në dijeni të faktit se shtetasi F. D. do të ishte i pranishëm në këtë udhëtim, siç edhe u konfirmua nga subjekti gjatë seancës dëgjimore.*
173. Duke mbajtur në konsideratë qëndrimin e GjEDNj-së në çështjen *Thanza kundër Shqipërisë*²⁹, dhe në çështjen *Regner kundër Republikës Çeke*, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit³⁰, si dhe në zbatim të nenit F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, në zbatim të vendimit të ndërmjetëm të datës 20.02.2025, trupi gjykues, më datë 03.03.2025, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar të çështjes, u njoh drejtpërdrejt pranë institucionit ligjzbatues me informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, me të cilin ishin njohur më parë Komisioni dhe vëzhguesi ndërkombëtar i çështjes. Ky verifikim u krye me qëllim vlerësimin e bazueshmërisë së konstatimeve të Komisionit të mbështetura në këtë informacion, si dhe për të garantuar që kufizimi i aksesit të subjektit në këtë informacion, të shoqërohej me garanci procedurale të mjaftueshme dhe me një kontroll gjyqësor efektiv mbi përmbajtjen dhe rëndësinë e tij.
174. Në përfundim të verifikimit të drejtpërdrejtë të informacionit të klasifikuar, trupi gjykues vlerësoi se moszbulimi i tij ndaj subjektit të rivlerësimit justifikohet nga nevoja për mbrojtjen e burimit të informacionit dhe interesave të sigurisë që qëndrojnë në themel të klasifikimit. Duke marrë parasysh natyrën e informacionit dhe pasojat që mund të sillte ekspozimi i tij, trupi gjykues çmoi se kufizimi i së drejtës së subjektit për t’u njohur me këtë informacion ishte proporcional ndaj qëllimit legjitim të synuar dhe i balancuar nga kontrolli gjyqësor efektiv i ushtruar mbi përmbajtjen, besueshmërinë dhe rëndësinë e tij për çështjen në shqyrtim.
175. Trupi gjykues vlerëson se, ndonëse subjektit të rivlerësimit nuk iu vu në dispozicion vetë informacioni i klasifikuar, ai u informua në një masë të mjaftueshme për thelbin e dyshimeve

²⁷ Avokat mbrojtës i F. D. gjatë gjykimit të çështjes penale nr. {***}/2011.

²⁸ Pronar i automjetit BMW të sekuestruar në kuadër të procedimit penal nr. {***}/2011, automjet me të cilin ka udhëtuar shtetasi F. D. në kohën që është ndaluar prej forcave të policisë në vitin 2011 dhe i është gjetur që mbante një armë zjarri, pistoletë e tipit “bereta”, pa leje të organeve kompetente.

²⁹ Shih: <https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-225653>, vendimi i GjEDNj-së, çështja *Thanza kundër Shqipërisë*.

³⁰ Vendimet e Kolegjit nr. 7, datë 24.06.2020, nr. 14, datë 14.09.2020 dhe nr. 31, datë 27.07.2022.

dhe konstatimeve të mbështetura në këtë informacion, përmes pyetjeve të adresuara gjatë hetimit administrativ në pyetësin nr. 2, në rezultatet e hetimit dhe në seancën dëgjimore³¹. Në këto kushte, subjektit iu garantua një mundësi reale dhe efektive për të kundërshtuar këto konstatime, për të dhënë shpjegime dhe për të paraqitur prova në mbështetje të qëndrimit të tij, duke ruajtur kështu ekuilibrin ndërmjet kërkesave të konfidencialitetit dhe të drejtave të mbrojtjes.

176. Ndonëse subjekti i rivlerësimit kundërshtoi përdorimin në proces të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, ai nuk pretendoi se konstatimi mbi ekzistencën e komunikimeve telefonike të tij me shtetasin F. D., ishte i pavërtetë. Për rrjedhojë, kundërshtimet e tij u fokusuan në lejueshmërinë dhe mënyrën e përdorimit të këtij informacioni, dhe jo në vërtetësinë e faktit që rezultonte prej tij.
177. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimet e subjektit të rivlerësimit, sipas të cilave udhëtimi ka qenë rastësor dhe se ai nuk ka pasur dijeni për praninë e shtetasit F. D., janë të pabesueshme.
178. Tërësia e fakteve të provuara nga të dhënat e sistemit TIMS, nga aktet procedurale të nënshkruara nga subjekti i rivlerësimit në kuadër të procedimit penal të vitit 2011 ndaj shtetasit F. D., si dhe nga informacioni i klasifikuar që evidenton kontaktet telefonike dhe takimet e subjektit me këtë shtetas përpara udhëtimit të datës 07.12.2013, e çojnë trupin gjykues në përfundimin se subjekti i rivlerësimit jo vetëm ka mbajtur kontakte dhe është shoqëruar me një person të përfshirë në veprimtari kriminale, por edhe ka qenë i pasinqertë në deklaratimet e dhëna lidhur me këto rrethana. Mohimi prej tij i këtyre kontakteve bie në kundërshtim me provat e administruara dhe vlerësohet si sjellje e pasinqertë si gjatë procesit të zhvilluar në Komision, ashtu edhe në ankimin e paraqitur përpara Kolegjit. Kjo sjellje nuk përputhet me standardet e integritetit, korrektësisë dhe transparencës që publiku pret nga një magjistrat.
179. Në përfundim të kësaj analize, trupi gjykues arrin në të njëjtin përfundim me Komisionin se faktet dhe rrethanat e provuara gjatë procesit, të vlerësuara në mënyrë tërësore në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, janë të tilla që cenojnë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

➤ *Lidhur me procedimin penal ndaj shtetasit V. A.:*

180. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar në ankim vlerësimin e Komisionit lidhur me procedimin penal nr. {***}/2012 pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me të pandehur V. A., se: *Duke marrë në konsideratë faktet se: (i) subjekti i rivlerësimit ka një marrëdhënie interesi me shtetasin V. A., pasi jeton me qira në një apartament në godinën në pronësi të tij nga viti 2009; (ii) gjatë kohës së qëndrimit në banesën e këtij shtetasi, nga Prokuroria e Rrethit Vlorë kryheshin hetime për veprën penale “Plagosje e lehtë me dashje” për qiradhënsin; (iii) në këtë kohë (viti 2012), subjekti ka qenë në pozicionin e drejtuesit dhe bënte shpërndarjet e çështjeve pranë prokurorëve përkatës; (iv) dënimi i kërkuar nga prokuroria për shtetasin V. A. ka qenë në minimum të masës së dënimit, sipas nenit 89 të Kodit Penal, gjobë 90.000 lekë,*

³¹ Faqe 37 e procesverbalit të seancës dëgjimore.

rrethanë kjo e cila, e parë së bashku me problematikat e evidentuara më herët, mund të çojë në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e të dëmtuarit te sistemi i drejtësisë. Në përfundim, Komisioni vlerëson se konkluzionet e renditura më lart duhet të merren në konsideratë në vlerësimin tërësor, në kuptim të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 dhe pikës 5 të nenit 61.

181. Në lidhje me këtë çështje, Komisioni ka arsyetuar se subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion procedurën e ndjekur prej tij, në cilësinë e Drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për caktimin e procedimit penal në fjalë prokurorit A. K. Në mungesë të dokumentacionit që të mundësonte verifikimin e mënyrës së shpërndarjes së çështjes, Komisioni ngriti dyshime se procedimi mund t'i ishte caktuar këtij prokurori me ndërhyrjen e subjektit të rivlerësimit, me qëllim kualifikimin e veprës penale në një formë më të lehtë nga ajo që, sipas Komisionit, diktohej nga rrethanat e çështjes. Ky dyshim u mbështet në faktin se, në kohën e hetimit dhe gjykimit të procedimit penal, subjekti i rivlerësimit kishte marrëdhënie qiraje me shtetasin V. A., pasi banonte në një ndërtesë në pronësi të këtij të fundit, ku ai jetonte edhe vetë. Sipas Komisionit, kjo rrethanë ishte e tillë që ka krijuar te personi i dëmtuar nga vepra penale D. H., perceptimin se shtetasi V. A. ishte favorizuar nga subjekti gjatë trajtimit të çështjes.
182. Në kundërshtim të këtij konkluzioni, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se caktimi i prokurorit përgjegjës për ushtrimin e ndjekjes penale në rastin konkret, është kryer në përputhje me rregullat e brendshme në fuqi, konkretisht sipas listës së gatishmërisë së miratuar në fillim të çdo muaji dhe, në raste të veçanta, duke marrë në konsideratë ngarkesën e secilit prokuror. Sipas subjektit, këto rregulla parashikoheshin në “Rregulloren e përgjithshme për funksionimin e prokurorive të shkallës së parë” dhe në “Rregulloren e brendshme të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë”.
183. Subjekti ka pretenduar më tej se Komisioni duhej të kishte prezumuar zbatimin e këtyre rregullave, për sa kohë nga informacioni i përcjellë prej Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, rezultonte se shpërndarja e çështjeve kryhej sipas rregullores, ndërsa listat e gatishmërisë nuk ruheshin në arkivin e institucionit.
184. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se shtetasi V. A. është proceduar, akuzuar dhe dërguar në gjykim në përputhje me ligjin, ndërsa Komisioni nuk ka evidentuar asnjë shkelje konkrete në lidhje me hetimin apo ndjekjen penale të zhvilluar ndaj tij që mund të lidhej me veprimtarinë profesionale të subjektit. Në këtë kuadër, subjekti ka pretenduar se lloji dhe masa e dënimit përcaktohen nga gjykata gjatë gjykimit, ndërsa prokurori ushtron funksionet e tij në mënyrë të pavarur, në përputhje me kompetencat e përcaktuara nga ligji.
185. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të Komisionit lidhur me këtë çështje, konstatoi se procedimi penal nr. {***}/2012 është regjistruar nga subjekti i rivlerësimit mbi bazën e materialeve të referuara nga policia gjyqësore në Komisariatit e Policisë Vlorë për denoncimet e shtetasve V. A. dhe D. H., të cilët në mënyrë të anasjelltë kanë kallëzuar njëri-tjetrin lidhur me një ngjarje të ndodhur në datën 25.1.2012, në lagjen “{***}”, në qytetin e Vlorës, ku këta shtetas janë konfliktuar fizikisht.

186. Në datën 30.01.2012, bazuar në materialet e referuara nga policia dhe aktet e ekspertimit mjekoligjor³², subjekti i rivlerësimit ka konstatuar se ka dyshime të arsyeshme që fakti i referuar përbënte veprën penale “Plagosje e lehtë me dashje” sipas nenit 89 të Kodit Penal dhe, për këtë arsye, ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal. Për trajtimin e këtij procedimi, subjekti ka caktuar prokurorin A. K.
187. Komisioni ka administruar dosjen e procedimit penal nr. {***}/2012, si dhe ka kërkuar informacion nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë³³ lidhur me procedurën e hedhjes së shortit për këtë çështje. Në përgjigjen e saj³⁴, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka informuar se shpërndarja e çështjeve për këtë periudhë, është bërë nga drejtuesi i prokurorisë sipas listës së gatishmërisë mujore.
188. Pas përfundimit të hetimeve, çështja ka kaluar për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Në konkluzionet përfundimtare, prokurori i çështjes A. K. i ka kërkuar gjykatës deklarimin fajtor të të pandehurit V. A. për kryerjen e veprës penale të “Plagosjes së lehtë me dashje”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 89 dhe 25 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 90.000 lekë gjobë, duke ulur masën e dënimit me një të tretën, bazuar në nenin 406 të Kodit të Procedurës Penale.
189. Në përfundim të analizës së akteve të procedimit penal, trupi gjykues vlerëson se nuk provohet asnjë veprim apo mosveprim i subjektit të rivlerësimit në kundërshtim me ligjin lidhur me regjistrimin e procedimit penal, caktimin e prokurorit të çështjes apo mënyrën e ushtrimit të ndjekjes penale. Gjithashtu, nuk rezulton e provuar as ndonjë formë ndikimi ose ndërhyrjeje e subjektit në veprimtarinë e prokurorit përgjegjës për çështjen.
190. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se konkluzioni i Komisionit lidhur me këtë çështje, është bazuar në një dyshim që, megjithëse logjik dhe i kuptueshëm në rrethanat e rastit, nuk mbështetet nga provat e administruara dhe, për rrjedhojë, nuk mund të merret si bazë për një konkluzion penalizues ndaj subjektit të rivlerësimit.
191. Pavarësisht sa u arrit në përfundim më sipër, trupi gjykues vlerëson se, pas regjistrimit të procedimit penal ndaj shtetasit V. A., subjekti i rivlerësimit duhej të kishte marrë masa për ndërprerjen e marrëdhënies së qirasë me këtë shtetas, me qëllim shmangien e çdo perceptimi të mundshëm se ai mund të favorizohej për shkak të kësaj marrëdhënieje. Vazhdimi i marrëdhënies së qirasë gjatë kohës kur çështja ishte në fazën e hetimit dhe më pas të gjykimit, nuk është në përputhje me standardet e kujdesit dhe etikës që priten nga një magjistrat. Megjithatë, duke vlerësuar natyrën dhe peshën e kësaj sjelljeje në tërësinë e rrethanave të çështjes, trupi gjykues çmon se ajo përbën një sjellje etike të papërshtatshme jashtë ushtrimit të funksionit, por nuk arrin një shkallë të tillë rëndësie sa të kualifikohet si cenim i besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

³² Në lidhje me dëmtimet që kanë pësuar të dy shtetasit: Shtetasi D. H., sipas aktit të ekspertimit mjekoligjor nr. {***}, datë 26.01.2012, ka pësuar dëmtime që kanë shkaktuar aftësi të përkohshme në punë mbi 9 ditë. Shtetasi V. A., sipas aktit të ekspertimit mjekoligjor nr. {***}, datë 26.01.2012, ka pësuar dëmtime që kanë shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë deri në 9 ditë.

³³ Shkresë nr. {***} prot., datë 28.6.2021.

³⁴ Shkresë nr. {***} prot., datë 8.7.2021, nuk ka bashkëlidhur listën e gatishmërisë mujore.

➤ *Lidhur me procedimin penal me të dëmtuar shtetasin S. A.:*

192. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar në ankim vlerësimin e Komisionit se: *Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka kryer të gjithë hapat hetimorë për identifikimin e personit të tretë që ka ushtruar dhunë ndaj të dëmtuarit S. A. dhe se kjo mangësi hetimore duhet marrë në konsideratë në vlerësimin tërësor të subjektit të rivlerësimit.*
193. Komisioni ka arsyetuar në vendim se subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm lidhur me pamundësinë dhe moskryerjen e veprimeve hetimore që lidheshin me identifikimin e personit të tretë që ka ushtruar dhunë ndaj të dëmtuarit S. A. Në përfundim, Komisioni vlerësoi se subjekti nuk ka kryer të gjithë hapat hetimorë të nevojshëm për identifikimin e personit të tretë që ka ushtruar dhunë ndaj të dëmtuarit S. A. dhe se kjo mangësi hetimore duhet marrë në konsideratë në vlerësimin tërësor.
194. Subjekti i rivlerësimit e ka kundërshtuar në ankim vlerësimin e Komisionit si të pabazuar, pasi nga aktet e çështjes konstatohet se ai nuk ka mbajtur qëndrim favorizues ndaj dy të pandehurve të identifikuar si autorë të veprës penale dhe se mosidentifikimi i autorit të tretë nuk lidhet me veprimet e hetimit të realizuara prej tij, por për shkak të mosidentifikimit në mënyrë operative të këtij personi nga policia.
195. Nga shqyrtimi i akteve të fashikullit të Komisionit lidhur me këtë procedim penal, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit, ka hetuar një ngjarje të ndodhur në datën 5.9.2015, në fshatin {***} të Vlorës, ku shtetasi S. A. është goditur me mjete të forta nga tre shtetas brenda një autoveturë, duke pësuar dëmtime në fytyrë dhe trup që kanë shkaktuar paaftësi në punë mbi 9 ditë. Lidhur me këtë ngjarje, janë marrë të pandehur shtetasit N. A. dhe T. B., të cilët janë akuzuar për veprat penale “Plagosje e lehtë”, në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 89 dhe 25 të Kodit Penal, dhe “Heqja e paligjshme e lirisë”, parashikuar nga neni 110, paragrafi i dytë i Kodit Penal. Nga hetimet, nuk është identifikuar autori i tretë i kësaj ngjarjeje.
196. Pas përfundimit të hetimeve, subjekti i rivlerësimit e ka kaluar çështjen për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, e cila, nëpërmjet vendimit nr. {***}, datë 11.2016, ka vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurit N. A. dhe dënimin e tij për veprat penale për të cilat akuzohej, kurse i pandehurit tjetër T. B. është deklaruar i pafajshëm. Kundër këtij vendimi, subjekti i rivlerësimit ka ushtruar ankim në gjykatën e apelit.
197. Trupi gjykues konstaton se Komisioni, në arsyetimin e vendimit objekt kontrolli, nuk ka identifikuar dhe as ka argumentuar konkretisht se cilat ishin veprimet hetimore që duhej të ishin kryer nga subjekti i rivlerësimit dhe që kanë mbetur të parealizuara në funksion të identifikimit të autorit të tretë të ngjarjes. Në mungesë të një analize të tillë, fakti që organet ligjzbatuese nuk arritën të identifikonin këtë autor, nuk mund t’u atribuohet apriori veprimeve apo mosveprimeve të subjektit të rivlerësimit. Dështimi i hetimit për të arritur një rezultat të caktuar, nuk përbën, në vetvete, provë të ekzistencës së mangësive në veprimtarinë hetimore të subjektit. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se konkluzioni i Komisionit lidhur me veprimet hetimore të subjektit në këtë procedim penal, nuk mbështetet në një analizë të plotë dhe në prova të mjaftueshme, ndaj e gjen atë të pabazuar.

198. Bazuar në përfundimet e arritura në këtë vendim lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm, duke u gjendur në kushtet e nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
199. Lidhur me marrëdhënien e subjektit të rivlerësimit me shtetasin F. D., si dhe mungesën e sinqeritetit të treguar prej tij gjatë procesit të rivlerësimit në lidhje me këtë marrëdhënie, trupi gjykues vlerësoi se këto rrethana, të analizuara në tërësinë e tyre, cenojnë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
200. Për rrjedhojë, vendimi i Komisionit u gjet i mbështetur në fakte dhe në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

- Lënien në fuqi të vendimit nr. 448, datë 21.09.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Erion Çelaj.

- Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 03.03.2025.

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

RELATOR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

KRYESUESE

Ina RAMA

nënshkrimi